

REVISTA STUDENTORE UNTstudenti

ZËDHËNËSE PËR TË ARRITUR NË BOTËN S SHKENCËS DHE DIJES

Letra e rektorit të UNT-së prof. dr. Azis Pollozhani drejtuar studentëve

Së bashku do ta përballojmë edhe këtë sfidë! (fq.3)

Arsimi në kohë pandemie! (fq.4)

Pesë vite nga themelimi i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Institucioni i shkencës, emancipimit dhe barazisë! (fq.6)



Me rastin e ndarjes së titullit të dytë Doctor Honoris Causa

UNT-ja nderon Akademik Ali Aliun me titullin më të çmuar! (fq.9)




Përshtypjet e studentëve që morën pjesë në mobilitetin e Erasmus+ (fq.18)

Risitë e teknologjisë: Teknologjia më shumë se kurrë në mesin tonë! (fq.22)

Përmbajtja

4 Në prag të fillimit të Vitit të Ri Akademik 2020/2021!
(Emel Aliju)



5 Arsimi në kohë pandemie
(Alma Maliqi)

6 Pesë vjet nga themelimi i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup
(Emel Aliju)



8 Përkushtim për një ardhmëri më të mirë!
(Hajrie Farizi)

- 9** Akademik Ali Aliu - “Doctor Honoris Causa” për kontributin e tij në fushën e Albanologjisë | Përgaditi: Emel Aliju
- 10** Bashkëpunimet e UNT- së gjatë vitit 2020
Përgaditi: Emel Aliju
- 12** Sfidat e pandemisë nga këndvështrimi i studentëve | Përgaditi: Gentuar Ismaili
- 13** UNT-ja ngelet promotore e bashkëpunimit ndëruniversitar! | Përgaditi: Emel Aliju
- 14** Shumë aktivitete si rezultat i përkushtimit dhe seriozitetit!
Përgaditi: Herolinda Ramadani
- 18** Shpikësi i tre aplikacioneve për përdoruesit e platformës “LinkedIn”
Përgaditi: Alejna Saiti
- 19** Studentët e përzgjedhur të UNT-së për“ ese më të mira”
- 20** Përvoja dhe suksesi i tyre si motivim dhe frymëzim për studentët e rinj!
Përgaditi: Alejna Saiti
- 22** Përvojë e shkëlqyeshme shkencore, por edhe njohje me kultura, vende dhe njerëz të ndryshëm! | Përgaditi: Esra Demiri
- 24** Me rastin e promovimit të numrit të parë të Revistës dhe hapjes së Radios në UNT
Përgaditi: Emel Aliju
- 26** Teknologjia më shumë se kurrë rreth nesh!
Ajsun Ismaili
- 28** “A më beson” romani përtej imagjinatës!
Përgaditi: Emel Aliju
- 29** Në organizim të UNT-së, për herë të parë në vend u zhvillua dita e cost-it
Përgaditi: Emel Aliju
- 30** Ballkani i stereotipizuar!
Enisa Amiti
- 34** Trajnimet e Studetave të UNT-së
Përgaditi: Alma Maliqi
- 36** Të bashkuar mundemi më shumë!
- 39** Çka ofron UNT

Këshilli i revistës studentor
Hajrie Farizi, kryetare e Unionit të studentëve
Emel Aliju, redaktore përgjegjëse

Koordinator: Prof.dr.Mustafa Ibrahim

Anëtarët e Këshillit redaktues:
Rasim Ajredini, Alma Maliqi, Elvana Mustafa,
Esra Demiri, Alejna Saiti, Herolinda Ramadani,
Bejhan Alili.

Letra motivuese e rektorit të UNT-së
prof. dr. Azis Pollozhani drejtuar studentëve

Së bashku do ta përballojmë edhe këtë sfidë!

Emel Aliju

Padyshim, viti që lamë pas ishte një vit më ndryshe nga vitet e tjera. Ky ishte një vit shumë i vështirë për të gjithë ne, madje i prekur ishte dhe ende është i gjithë universi. Shumë dëshpërime, pezullime të planeve por jo dështime, në një apo tjetër mënyrë suksesin gjithmonë e gjetëm pasi që i kishim në mbështetje të gjithë profesorët dhe profesoret, të cilët u angazhuan më shumë se kurrë për të na qëndruar pranë, duke mos lënë anash dhe rektorin prof. dr. Aziz Pollozhani i cili ishte si gjithmonë më afër se kurrë pranë studentëve. Duke na këshilluar dhe dhuruar një mbështetje jashtëzakonisht të madhe, herë pas here dhe “ Letra motivuese “.



Prof. dr. Azis Pollozhani

Letra motivuese e rektorit Pollozhani filloi me falënderime ndaj studentëve, kelegeve dhe kolegëve për mirëkuptimin dhe kontributin e tyre dhe theksoi se ky kontribut dhe ky bashkëpunim do të duhet të vazhdojë edhe më me shumë suksese, sepse ballafaqimi me efektet e pandemisë COVID-19, sipas gjitha gjasave, do të vazhdojë.

Unë jam i sigurtë që ky bashkëpunim do të jetë në nivelin e duhur sikurse edhe deri më tani, mirëpo duke marrë parasysh përvojën e semestrit të kaluar më duhet të ju lus për një syçelësi dhe korrektësi edhe më të madhe për respektimin e masave parandaluese shëndetësore. Higjiena personale, distanca fizike mes nesh dhe sidomos mbajtja e maskave mbrojtëse në fytyrë mbetet obligim i përditshëm gjatë qëndrimit në ambientet e universitetit. Për një vit të suksesshëm akademik dhe për të kursyer shëndetin e secilit prej nesh ju ftoj që të gjithë, me sjelljen tonë, të jemi në nivelin e duhur të përgjegjësisë qytetare dhe akademike dhe të respektojmë normat për të cilat bashkë jemi dakorduar “, shkroi rektori Aziz Pollozhani për studentët.

Këshillat gjithmonë janë të mirseardhura tek studentët po gjithashtu dhe rregullat zbatohen kur bëhet fjalë për shëndetin. /

Në prag të fillimit të Vitit të Ri Akademik 2020/2021!

Universiteti “ Nënë Tereza “ - Shkup shënoi fillimin e Vitit të Ri Akademik 2020/2021 me një ceremoni të organizuar në përputhje me Protokolet në fuqi për parandalimin e pandemisë. Për shkak të pandemisë, UNT-ja mirëpriti studentët e rinj, në grupe të vogla. Ndërsa ceremonitë pritëse u bënë gjatë dy ditëve, duke respektuar të gjitha rekomandimet shëndetësore.


Rektori i Universitetit “ Nënë Tereza “ - Shkup, prof. dr. Aziz Pollozhani në fjalën e tij mirëseardhëse tha se me gjithë vështirësitë e krijuara nga paraqitja e pandemisë COVID-19, që ka kapluar gjithë globin, UNT-ja do të vazhdojë me realizimin e misionit të vet edhe në këto kushte specifike. Këtë vit orën e parë akademike e filluam me studentët e arkitekturës dhe ndërtimtarisë si bartës të simbolit për ndërtimin e të ardhmës. Gjeneretës sonë dhe komunitetit akademik u ra në hise që ta përjetojmë dhe ta përballojmë një efekt të pakëndshëm të rrjedhava globalizuese sikurse është pandemia COVID-19.

Prof. dr. Aziz Pollozhani tha se: “ Detyra jonë e përbashkët është që jo vetëm ta tejkalojmë këtë sfidë por gjeneratat e ardhshme t’i përgatisim edhe për sfida tjera, të llojeve të ndryshme, që mund t’ua sjellë e ardhmja. “ Përshtatja dinamike e studimeve për përgjigje adekuate dhe efektive në këtë situatë të imponuar do të jetë angazhimi ynë i përbashkët në periudhën që kemi para nesh.



“Në emër të Këshillit të Rektoratit, të prorektorëve, dekanëve dhe gjithë stafit akademik e administrativ ju uroj mirëseardhje në familjen tonë të madhe, ku do të kalojmë vitet e ardhshme” tha Pollozhani duke apeluar studentëve që me përpikmëri të respektojnë masat për mbrojtje nga virusi korona.

UNT si një tempull i ri i shkencës dhe i dijes, i vetmi universitet publik në gjuhën shqipe në kryeqytet, studentëve ju uroi shëndet dhe suksese në studimet e tyre akademike. /



Alma Maliqi

Arsimi në kohë pandemie

Pandemia COVID-19 që u përhap në mbarë botën, preku të gjitha shtresat dhe sferat e jetës, duke ndikuar dukshëm në standardin dhe ekonominë e shteteve të ndryshme. Ekonomia, shëndetësia dhe akademia janë ndër sferat më të prekura nga masat parandaluese të ndërmarra për luftimin e gjendjes pandemike nga COVID-19.

Janë mbyllur institucione dhe veprimtari që mund të bëhen valë e perhapjes së COVID-19, shkollat, universitetet hyjnë në këtë kategori. Që në muajin Mars 2020 janë mbyllur të gjitha mësimi ka vazhduar në distancë për vitin shkollor 2020-2021.

Padyshim që fillimi i procesit mësimorë me prezencë në shkollë është skenari që të gjithë e preferojmë për shkak të arritjes së një cilësie më të lartë arsimore, rrjedhimisht temë dhe sfidë kryesore mbetet mësimi online dhe përgatitja e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve për të zbatuar mësimin në distancë. Në nivelin univeristar si dhe në shkollimin parauniversitar privat, mësimi po organizohet përmes platformave moodle, google classroom, google meet, zoom dhe webeex. Vështirësi më të theksuara patën shkollat fillore dhe të mesmet, por nuk mbeten të përjashtuar as fakultetet, ndërsa interneti është në rritje të lartë për të gjitha grupmoshat.

Gjithçka ka qenë e papërgatitur për një situatë të tillë, sidomos në nivelin e arsimit, askush nuk ka

menduar se do të ndodh një gjë të tillë dhe sa do të zgjas nuk e dimë. Një numër shumë i madh nuk pajtohet me mësimin onlajn, sidomos në mënyrë se si po organizohet, nuk është po aq efektive për shkak të mungesës së theksuar të ndërveprimit në mes të shkollave, mësimdhënësve nxënësve dhe studentëve. Nga ana tjetër u theksua se shkolla është institucion arsimor që duhet të ketë në qendër nxënësit dhe studentët dhe të organizojë një program që është në përputhje me kushtet tjera, ku studentët nuk duhet të tejngarkohen, por ata duhet të përkrahen që të tejkalojnë këtë krizë. Mendoj se gjithçka është biseduar e është folur, pyetje, kritika, diskutime etj.

Si përfundim edhe pse mësimi mund të mos jetë plotsisht efektiv, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që mësimi të mos anulohet dhe të organizohet mësim shtesë, përfshirje e grupeve, aktivizimi i të gjithë mësimdhënësve në procesin mësimor. Menjëherë me normalizimin e situatës, shkollat, fakultetet duhet të fuqizohen dhe të funksionalizojnë sistemin e komunikimit me nxënësit, studentët dhe prindër në nxitjen dhe mbikqyrjen e mësimin jo vetëm për këtë pandemi por edhe të situatave tjera në të ardhmen. Të përfundohet viti shkollor me çdo kusht, duke bërë angazhime shtesë, duke përdorur kriteret të cilat kanë parasysh planin mësimor dhe kushtet në të cilin është organizuar mësimi. Shpresojmë dhe urojmë që kjo kohë pandemie mos të lë pasojë të mëdha në mesin tonë. /



Pesë vjet nga themelimi i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Institucioni i shkencës, emancipimit dhe barazisë!

Me rastin e pesëvjetorit të miratimit të Ligjit për Themelimin e Universitetit "Nënë Tereza" - Shkup, Senati i Universitetit mbajti një Seancë solemne në të cilën shprehu mirënjohjen e tij për besimin e treguar nga iniciatorët për themelimin e universitetit të parë shtetërorë në gjuhën shqipe në kryeqytet dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që votoi atë.

Senati i UNT-së shfrytëzon këtë mundësi për t'i riafirmuar përpjekjet dhe arritjet e deritanishme të Universitetit, gjë që konfirmon edhe një herë justifikimin, përshtatshmërinë dhe afatet kohore të vendimit për krijimin e tij.

Sot, Universiteti "Nënë Tereza" - Shkup ka shumë arsye për të qenë krenar për arritjet që ka bërë në



Emel Aliju

pesë vitet e para të ekzistencës së tij. Rritja graduale e numrit të studentëve, që aktualisht është mbi 2,000 studentë të regjistruar në ciklin e parë dhe mbi 200 të regjistruar në ciklin e dytë të studimit. Nga këto të dhëna inkurajuese dalin përpjekjet serioze aktuale të Universiteti “ Nënë Tereza “ - Shkup për të nisur ciklin e tretë të studimeve.

Në plan ndërkombëtar, aspiratat e vazhdueshme për njohje dhe afirmim të shtuar ndërkombëtar në periudhën e kaluar, kanë rezultuar në nënshkrimin e më shumë se 50 marrëveshjeve të partneritetit dhe rrjetëzimit me institucionet e arsimit të lartë në rajon dhe më gjerë. Në të njëjtën kohë, që nga nënshkrimi i “ Kartës Erasmus+ për Arsimin e Lartë “, Universiteti ka marrë rregullisht grante për realizi-

min e mobilitetit të studentëve dhe bursa për zhvillimin profesional të stafit të universitetit. Meritat më të mëdha për këto arritje të Universitetit kanë stafi akademik dhe administrativ për punën e palodhur dhe angazhimin rezerv, por edhe mirëkuptimi dhe mbështetja e vazhdueshme nga studentët.

Që nga fillimi i veprimtarisë mësimore, shkencore dhe të zbatuar të Universitetit, misioni i tij është, duke harmonizuar ofertën e tij akademike me dinamikën e mjedisit shoqëror dhe duke ushqyer parimet e barazisë, diversitetit dhe multikulturalizmit, të krijojë një mjedis stimulues për të mësuarit tërëjetësorë dhe në kontinuitet. Pesë vite pas vendosjes së këtyre qëllimeve të larta, ne i jemi thellësisht mirënjohës stafit tonë, por edhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organeve të tjera shtetërore që përmes mbështetjes së vazhdueshme ndihmuan në realizimin e misionit tonë. Sidoqoftë, duke njohur aspiratat dhe nevojat reale të Universitetit si një institucion i ri i arsimit të lartë që po përballlet me zhvillim të shpejtë, ne e shfrytëzojmë këtë mundësi për të theksuar nevojën për më shumë mbështetje dhe angazhim nga institucionet shtetërore në mënyrë që të kapërcejmë sfidat themelore në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës dhe konsolidimit akademik.

Në këtë kontekst, me rëndësi të veçantë për përmirësimin e cilësisë dhe konkurrencës së Universitetit është zbatimi i menjëhershëm i vendimeve të qeverisë dhe zbatimi efikas i procedurave për ndërtimin e kompleksit të ri Universitar “Nënë Tereza”, në zonën e parashikuar nga vendimi i Qeverisë. Ne jemi thellësisht të bindur se fillimi i realizimit të zgjidhjes hapësinore, do të përmirësojë profilin e Universitetit si një mjedis progresiv i përshtatshëm për kërkimin shkencor modern. Me mall dhe mirënjohje të thellë, përkujtojmë sot z. Abdilqim Ademi i cili në cilësinë e tij si Ministër i Arsimit dhe Shkencës në vitin 2015 njohu nevojën e themelimit të Universitetit dhe mbështeti pa rezerva nismën për krijimin e tij.

Në të njëjtën kohë, ne edhe një herë shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare, mediat dhe gjithë arsimdashësit tjerë, dhe bindjen tonë të vendosur se mbështetja e dhënë deri më tani do të vazhdojë me intensitet të shtuar dhe do të rezultojë në një zhvillim të përshpejtuar të mëtejshëm të Universitetit “ Nënë Tereza “ - Shkup. /

Përkushtim për një ardhmëri më të mirë!

Hajrije Farizi e lindur në Shkup në komunën e Sarajit, studente e Universitetit “Nënë Tereza” - Shkup, në Fakultetin e Shkencave Sociale, Studime Europiane. Hajria është e kyçur në disa organizata studentore dhe si vullnetare në Sekretariatin për Çështje Evropiane, për zhvillimin e shkathtësive dhe zgjerimin e njohurive. Më 19 dhjetorë 2019 është zgjedhur si kryetare e Kuvendit Studentor në kuader të Universitetit “ Nënë Tereza ” - Shkup.

Gjithçka ndodhi papritur, ishte një moment që më dhuroi shumë emocione dhe lumturi por në të njëjtën kohë edhe shumë përgjegjësi. Ky rrugëtim i ri, që papritmas u shfaq para meje, nga dita e parë e deri më sot më obligoi që të angazhohem me vendosshmëri, korrektësi dhe përkushtimin më të madh. E dija se nuk është lehtë ta realizoj me sukses misionin për të cilën u zgjodha, megjithatë e pranova me shumë entuziazëm. Gjatë këtij mandati njëvjeçar, do të përdor i tëtë kapacitetin tim dhe aftësitë e smia për të arritur qëllime pozitive dhe për të përmbushur kërkesat e studentëve.

Ky emërim sa më dha autoritet, aq u rritën përgjegjësitë e mia. Që t'i përfaqësojë në mënyrë të denjë studentët, duhet të jetoj me problemet dhe nevojat e studentëve, që të përpiqem sadopak t'i relajoj dhe zgjidh problemet e tyre. Prioriteti kryesor i imi ka qenë dhe do të jetë kontakti i drejtëpërdrejtë me studentët.



Hajrije Farizi e lindur në Shkup në komunën e Sarajit, studente e Universitetit “Nënë Tereza” - Shkup, në Fakultetin e Shkencave Sociale, Studime Europiane.

Ne do të shqyrtojmë çdo kërkesë, ankesë apo ide që do të adresohet në Kuvendin Studentor. Ne do ta fuqizojmë edhe më shume zërin e studentëve.

Si gjithçka në jetë edhe jeta studentore ka sfida e vështirësi. Mirëpo gjithnjë ka edhe mundësi dhe shanse për t'i zgjidhur apo kontribuar, qoftë me këshillime, qoftë me përkrahje direkte. Duhet të punojmë dhe të sillemi pozitivisht, ndershmërisht vetëm e vetëm që studentët të kenë kushte më të mira për studime dhe jetën studentore.

Gjatë këtij mandati një nga qëllimet tona kryesore ka qenë aktivizimi i jetës studentore, kyçja e studentëve në mënyrë vullnetare në çdo aktivitet. Gjatë kësaj periudhe ne arritëm të vendosim në funksion “Radio Studenti” dhe revistën studentore “ UNTstudenti”. Për këtë sukses, përveç rektorit, ju falënderohemi edhe disa profesorëve si prof.dr.Mustafa Ibrahim, i cili i koordinoi 2 numrat e revistës, si dhe profesorëve Agron Kurtishi dhe Avni Avdiu. Më merritorja gjithsesi është edhe kryeredaktorja Emel Alju, e cila me përkushtimin dhe punën e palodhshme, së bashku me redaksinë arritën të botojnë dy numra të revistës studentore.

Synimi im deri në fund të mandatit do të jenë edhe bashkëpunimi mes kuvendeve studentore të të gjitha universiteteve publike dhe private, bashkëpunimi edhe me universitete nga vendi, Kosova dhe Shqipëria. Qëllimi ynë kryesor ngelet krijimi i një rrjeti studentor që do të përfaqëson nevojën e unifikimit të forcave studentore për të trasuar progresivitetin dhe idete e përbashkëta, me të vetmin qëllim ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë. /



Akademik Ali Aliu

“Doctor Honoris Causa” për kontributin e tij në fushën e Albanologjisë

Emel Aliju

Universiteti „Nënë Tereza” - Shkup në një ceremoni solemne i ndau titullin „Doctor Honoris Causa” Akademikut Ali Aliu. Komisioni recensues në përbërje akademik Luan Starova si kryetar, prof. dr. Mustafa Ibrahim i dhe prof. dr. Sunaj Raimi si anëtarë, së bashku me mendimin pozitiv të Drejtorisë Rektoriale të Universitetit, sollën vendim që akademik Ali Aliu t’i ndahet titulli „Doctor Honoris Causa” me motivacionin: „Për kontribut të shquar në zhvillimin e kulturës, arsimit dhe kërkimit shkencor, si studiues i shquar i shkencave albanologjike; historian i letërsisë dhe në veçanti i kritikës letrare shqiptare; si zë origjinal dhe kritik i problemeve të mëdha të kohës, të bazuara në kritikën e së vërtetës, si një ndër intelektualët më të shquar të kombit shqiptar”.

Akademik Luan Starova, në fjalën e tij tha se biografia e akademik Aliut është shumë e pasur dhe me shumë sfida gjatë gjithë karrierës së tij, gjithmonë pjesë e proceseve kombëtare dhe shpesh duke pësuar nga organet e rendit të ish-Jugosllavisë, dhe disa herë edhe i larguar nga puna. /



Bashkëpunimet e UNT- së gjatë vitit 2020

Pregaditi: Emel Aliju

Universiteti “ Nënë Tereza “ - Shkup ka nënshkruar Memorandum bashkëpunimi të ndryshme gjatë këtij viti akademik.



Universiteti “ Nënë Tereza “ - Shkup nënshkroi Memorandum bashkëpunimi me Bibliotekën Nacionale Universitare “ Shën Klimenti i Ohrit “ - Shkup. Me këtë memorandum dy institucionet, në ineteres të përbashkët do të bashkëpunojnë në sferën e arsimit, sigurimin e analizave të nevojshme shkencore, programeve për edukim dhe përsosmëri të kadrove. Konkretisht me këtë bashkëpunim, i hapen dert Qendrës së Botimeve dhe Sistemit Bibliotekar të udhëhequr nga prof.dr. Mustafa Ibrahim me çka krijohen kushte për shfrytëzimin e fondit libror të digjitalizuar dhe shkëmbimi i materialeve të bibliotekave në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera, të nevojshme sidomos për mësim nga sh-tëpia (online), në këtë gjendje të pandemisë. Memorandumi u nënshkrua nga rektori i Universitetit “ Nënë Tereza ” në Shkup, Prof. dr. Aziz Pollozhani dhe drejtori i Bibliotekës Nacionale Universitare “ Shën Klimenti i Ohrit “ në Shkup, Frymëzim Dauti.

Universiteti “Nënë Tereza” - Shkup dhe “Porche Macedonia” nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi, ku në bazë të këtij memorandum, parashihet që studentët e drejttimeve vijuese në Fakultetin e Shkencave Teknike (FSHT), pranë UNT-së: Mekatronikë, Inxhinieri transporti dhe komunikacioni, Inxhinieri makinerike dhe menaxhment, si dhe ata të Sistemeve elektroteknike, por jo vetëm këto, të mund të realizojnë punën praktike si pjesë e plan-programeve mësimore në hapësirat e kësaj kompanie. Memorandumi është nënshkruar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike, Prof. dr. Agim Mamuti, si dhe nga drejtuesit e kompanisë “Porche Macedonia”, Dr. Zllatko Mucunski dhe z. Cristofer Erlmoser.



Universiteti “Nënë Tereza” - Shkup nënshkroi memorandum bashkëpunimi me Qendrën për edukim joformal Creative Hub Maqedoni, i përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm i UNT-së, Mr. Bujar Kajolli. Qëllimi i këtij memorandum është themelimi i bashkëpunimit të nënshkruarve dhe partneritetit për angazhim të zhvillimit profesional të kadrove, mundësim të shkëmbimit të kadrove, mundësim për punë praktike për studentët më të mirë të Kreative Hub dhe studentëve të UNT-së në kompanitë bashkëpunuese të Kreativ Hub, në koordinim të përbashkët, organizim të ngjarjeve të



përbashkëta me qëllim të promovimit të të dy institucioneve përmes historisë së suksesit, bursave, organizimit të panairëve të karrierës etj.

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit “Nënë Tereza” - Shkup, mr. Bujar Kajolli me drejtorin e Agjencisë për zbatimin e gjuhës prof. dr. Ylber Sela nënshkruan memorandum bashkëpunimi.

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare filloi me temë “Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve”, ndërsa hapjen e bëri drejtori Ylber Sela, i cili u raportoi për punën e deritashme të institucionit të cilin e udhëheq, si dhe për qëllimet e mbajtjes së kësaj konference.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike, pranë Universitetit “Nënë Tereza” - Shkup, prof. asoc. dr. Agim Mamuti i shoqëruar nga prodekanet doc. dr. Olivera Petrovska dhe doc. dr. Teuta Jusufi-Zenku, si dhe ligjëruesi Mr. Zekirja Zekiri, nënshkruan memorandum bashkëpunimi me drejtorin gjeneral z. Xhemali Nuishi në hapësirat e Qendrës së kontrollit teknik “VIA” në Shkup.

Në bazë të këtij memorandum, parashihet që studentët e drejtimeve vijuese në FSHT: Inxhinieri transporti dhe komunikacioni, Inxhinieri makinerike dhe menaxhment, si dhe ata të Mekatronikës, por jo vetëm këto, të mund të realizojnë punën praktike si pjesë e plan-programeve mësimore në hapësirat e kësaj qendre.

Rektori i UNT-së prof. dr. Aziz Pollozhani sot priti në një takim pune ministrin e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Naser Nuredini.



Rektori Pollozhani i shoqëruar nga Prorektorët, Kryetari i Senatit si dhe Sekretari i Përgjithshëm gjatë takimit me ministrin Nuredini nënshkruan Memorandum që ka për qëllim zgjerimin e bashkëpunimit të ndërsjellë përmes shkëmbimit të mendimeve shkencore, profesionale, aplikative dhe praktikave në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Nënshkrimi i këtij dokumenti është rezultat i nevojës për të lidhur institucionet e tyre përmes shkëmbimit të përvojave shkencore dhe profesionale, njohurive dhe praktikave, përgatitjes së programeve të përbashkëta për aftësim shkencor-profesional dhe përsosjen e kuadrit inxhinieriko-teknik, përgatitjen e projekteve të përbashkëta, analiza dhe vlerësim në fushën e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Memorandumi gjithashtu mundëson shfrytëzimin e kushteve tekniko-profesionale, materialeve, lokaleve dhe laboratorëve si dhe pjesëmarrje në grupe pune për përgatitjen e ligjeve dhe akteve nënligjore, dokumenteve të planifikimit dhe llojeve të tjera të dokumenteve në fushën e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Rektori Pollozhani njoftoi Ministrin Nuredini për drejtimet e fakulteteve ku me theks veçant i ceku drejtimet për mbrojtje të ambientit ku UNT është e fokusuar më shumë në kuadrot deficitare, siç janë ato natyrore, aplikative, teknike dhe laboratorike.

Rektori Pollozhani i shoqëruar nga Kryetari i Senatit si dhe Sekretari i Përgjithshëm gjatë takimit me drejtorin Dimovski nënshkruan Memorandum me Agjencinë për Siguri Ndërkombëtare

që ka për qëllim zgjerimin e bashkëpunimit të ndërsjellë përmes shkëmbimit të mendimeve shkencore, profesionale, aplikative dhe praktikave në fushën profesionale mes dy institucioneve. Agjencia dhe Universiteti do të bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe do të japin ndihmë dhe përkrahje të ndërsjellë në lëmitë e mësimit praktik për studentët e Universitetit, vëmendje të veçantë do i'u kushton edhe veprimtarive aplikative dhe shkencore hulumtuese po dhe organizimeve të trajnimeve, tryezave të rrumbullakëta, debateve, konferencave dhe formave të tjera të ngjashme që bien në frytshmëri për vendin tonë, dhe jo vetëm. Memorandumi gjithashtu mundëson shfrytëzimin e kushteve tekniko-profesionale, materialeve, lokaleve si dhe pjesëmarrje në grupe pune për përgatitjen e ligjeve dhe akteve nënligjore, dokumenteve të planifikimit dhe llojeve të tjera të dokumenteve në fushën e sigurisë kombëtare. /



Covid-19

Sfidat e pandemisë nga këndvështrimi i studentëve

Gentuar Ismaili

Gjatë kësaj pandemie sikurse çdo individ, institucion apo organizatë që kishte pasojë ose sfida të ndryshme gjithashtu edhe studentët u ballafaquan me këto sfida. Mbyllja totale e vendit pamundësoi që studentët t'i realizojnë synimet dhe qëllimet personale dhe profesionale. Gjithashtu sfida më vete ishte edhe zhvillimi i procesit edukativo – arsimor online.

Studentët gjatë kësaj periudhe ishin të detyruar të paguajnë të gjitha taksat studentore dhe shumë pak ishin mbështetur nga shteti. Për të qenë më objektiv kam marrë edhe mendimet e kolegëve të tjerë.

Jeton Mustafa student i Fakultetit të Shkencave të Informatikës pranë UNT, tha se kemi pasur pasojë të ndryshme por si më e rëndësishme ka qenë mësimi online. “Si student kam hasë vështësi për qasje në mësim online”.

Altin Ajdini student i Fakultetit të Mjekësisë, pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, tha se kemi pasur më shumë pasojë psikologjike për shkak të dezinformimit të mediave në vendin tonë. “Fillimi i pandemisë ka ndikuar psikikisht, shkak i mortalitetit të madh dhe teorive konspirative, pastaj e kam rimirë vetën. Sidoqoftë”.

Abedin Ismaili student i Fakultetit të Gjuhëve Kulturore dhe Komunikimit – UEJL, tha se gjatë pandemisë humbi motivimi i studentëve dhe interaktiviteti mes tyre dhe profesorëve. “Periudha studentore vetëm si e tillë është sfiduese, aq më shumë kur u bë pandemi globale ku pasojat ishin evidente në ekonomi, shëndetësi dhe arsim. Sfida më e vështirë ishte përballja me mësimin online dhe e ndienim mungesën e mësimin tradicional”.

Elmedin Ibrahim student i Fakultetit Ndërkombëtarë Ballkanik, thotë se studentët gjatë pandemisë ishin shndërruar në pensionerë. “Pasoja më e madhe është mos aktivizimi i jonë dmth studentët që na ka bërë të ndjehemi sikur pensionist”.

Mendimet e kolegëve të fakulteteve të tjera janë që institucionet të jenë më të përgatitura në rrethana të jashtëzakonshme dhe urojnë që kjo gjendje të merr fund dhe të kthehemi në normalitet. /

Në Korçë nënshkruhet deklarata për bashkëpunimin midis universiteteve shqiptare

UNT-ja ngelet promotore e bashkëpunimit ndëruniversitar!

Emel Aliju

UNT nënshkroi deklaratën për bashkëpunim me të gjitha Universitet Shqiptare në suaza të Konferencës në Korçë me temë “Universitetet Shqiptare përballë sfidave të hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë”

Prorektori prof. dr. Bekim Fetaji, dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale prof. dr. Sunaj Raimi si dhe anëtari i senatit Prof. Dr. Mustafa Ibrahim i përfaqësoi Universitetin Nënë Tereza dhe morën pjesë në Korçë, në konferencën e II-të të Rektorëve të Universiteteve Shqiptare me temë: „Universitetet Shqiptare përballë sfidave të hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë”.


Organizimi ishte i Universitetit „ Fan S. Noli „ në Korçë, derisa konferenca punimet i ka zhvilluar me datë 6 dhe 7 Mars në Voskopojë.

Në këtë konferencë marrën pjesë edhe zëvendës ministrat e arsimit të Republikës së Shqipërisë, Oltion Rrumbullaku dhe ai i Republikës së Kosovës Xhavit Rexhaj, Rektorë, Prorektorë, dekanë, senatorë dhe disa profesorë nga të gjitha Universitetet Shqiptare, dhe trojet Shqiptare.

Prorektori i UNT-së prof. dr. Bekim Fetaji Nikoqirit të konferencës Rektorit të Universitetit Fan Noli, Korçë, Prof. Dr. Ali Jashari ia përcolli faleminderimet dhe respektet nga Rektori Prof. Dr. Aziz Pollozhani dhe i dorëzoi plaketë origjinale në mozaik të Nënë Terezës.



Në suaza të konferencës u nënshkrua edhe Deklarata për bashkëpunim midis të gjithë Universiteteve Shqiptare. /



Shumë aktivitete si rezultat i përkushtimit dhe seriozitetit!

Herolinda Ramadani

Viti 2020 mund të themi se nuk ishte nga më të lehtët, por ne e bëmë më të mirën tonë që të jemi sa më të aktivizuar, më të përfshirë dhe më optimist, mblodhëm fuqitë dhe forcat tona për ta bërë atë që bëjmë gjithmonë më së miri në universitetin tonë. Duke qëndruar së bashku më të fortë se kurrë qoftë edhe nga distanca, pasi që ne nuk e lamë pandeminë të drejtojë jetën tonë, por morëm masat paraprake për të mbrojtur veten dhe të dashurit tanë dhe për të drejtuar vetë rrugët tona. Planet, detyrat, aktivitetet janë ato të cilat na bashkojnë gjithmonë edhe pse po i organizonim dhe i realizonim nga distanca nuk kishte të ndalur për ne, gjë që tregon arritjet si një universitet dhe një komunitet. UNT-ja edhe pse kohë pandemie mbajti aktivitete të ndryshme të cilat kanë përfshirë të gjitha Fakultet e mundshme, po sigurisht aktivitete të cilat kanë qenë të organizuar vetë nga studentët dhe profesorët e UNT-së. Disa prej aktiviteteve që janë organizuar nga UNT-ja gjatë kohës së pandemisë.

Universiteti “ Nënë Tereza “ - Shkup si pjesë e konsorciumit prej 16 partnerësh mori pjesë në themelimin dhe implementimin e projektit ndërkombëtar e-VIVA, u përfaqësua nga rektori Prof. Dr. Azis Pollozhani, Dr. Diturije Ismaili dhe Ph.Dc. Elisabeta Bajrami Ollogu. Takimi 3-ditor u mbajt në universi-

tetin e Duisburg-Essen, Gjermani ku ndër të tjera u raportuan aktivitetet e realizuara deri tani prej partnerëve si dhe u diskutuan gjerësisht obligimet për hapat vijues të zbatimit të projektit. Projekti financohet nga Programi Erasmus+ nga fondet për arsim të Bashkimit Evropian dhe realizimi i plotë i tij pritet të përfundojë në Nëntor të vitit 2021.



Universiteti “ Nënë Tereza “ - Shkup dizajnon dhe prodhon mbrojtëse për punëtor shëndetësor. Në mbështetje të aktiviteteve për lehtësimin dhe ballafaqimin me pandeminë COVID-19, pedagogët e Fakultetit Teknik në bashkëpunim me kolegët e tyre nga Prishtina dhe Tirana dizajnuan dhe filluan të prodhojnë Mbrojtëse sekondare, jetike për mbrojtjen e punëtorëve shëndetësor dhe jo vetëm. Së shpejti të njejtat do të dhurohen punëtorëve shëndetësor



që janë në vijën e parë të luftës. Modeli prodhohet me printer 3D dhe ka një rreth plastik të cilës i bashkohet një fletë plastike e tejdukshme. Kjo garanton më tepër siguri për mjekët që u shërbejnë pacientëve me infeksionin e Covid-19. Vlen të përsëritet angazhimi i palodhur i pedagogut tonë Blerant Ramadani dhe mbështetja e prof. Dr. Shaban Buzës që bashkarisht realizuan këtë ide.

Më 06 Prill - Këndi Amerikan në Shkup, në bashkëpunim me Fakultetin e Sigurisë në Shkup, organizoi diskutim nga distanca, online, për nder të **4 Prillit** - datës së themelimit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut-NATO dhe anëtarësimit të plotë të vendit tonë në këtë aleancë. Në këtë diskutim, krahas Presidentit Stevo Pendarovski, kryeministrit teknik Oliver Spasovski dhe shefit të Zyrës së NATO-s në Shkup, kolonel Zoran Jankoviç, mori pjesë edhe Prof. dr. Rizvan Sulejmani, prorektor për marrëdhënie ndërkombëtare në UNT, me temë diskutimi "Rreziqet dhe kërcënimet globale". Diskutimi u ndjek edhe nga studentët të UNT-së.

"Ndaloni pandeminë: siguria dhe shëndeti në punë mund të shpëtojë jetë" është motoja e Ditës Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit për vitin 2020, e mbajtur çdo 28 Prill nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP). Ndërsa të gjithë janë të prekur nga pandemia globale COVID-19 dhe kriza, punëtorët janë në vijën e parë. Më shumë se kurrë, ngritja e vetëdijes për miratimin e praktikave të sigurta në vendet e punës dhe rolin e rëndësishëm që luajnë shërbimet e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të jenë në qendër të kësaj Dite Ndërkombëtare.

Fakulteti i Shkencave Teknike, Programi studimor "Inxhinieri për Mbrojtjen në Punë dhe të Mjedisit" pranë Universitetit "Nënë Tereza" - Shkup, ka për qëllim të aftësojë studentët në të gjitha aspektet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe në zbatimin e parimeve shkencore të inxhinierisë për të analizuar, ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e punës dhe mjedisit.

Në pamundësi të realizojnë vizitën e planifikuar në Kombinatin Xehtaro – Energjetik (KXE) "Oslome", Kërçovë, studentët e programit studimor "Inxhinieri për Mbrojtje në Punë dhe të Mjedisit", pranë Universitetit "Nënë Tereza" - Shkup, kishin rast të dëgjojnë një ligjëratë virtuale nga Mr. Sc. Ing. Isein Ajdari, i cili i njohu studentët me procesin teknologjik të Kombinatis, rreziqet dhe risqet në vendin e punës si dhe masat e sigurisë dhe shëndetit në punë. Studentët dhe Ass. Prof. Dr. Urime Demiri – Shaipi falenderojnë përzemërsisht z. Isein Ajdari për kohën dhe prezentimin e shkëlqyeshëm.

Në kuadër të aktiviteteve të shumta që ka ndërmarr Kuvendi Studentor i Universitetit "Nënë Tereza" - Shkup gjatë periudhës së COVID-19, sot nëpërmjet platformës "Google Meet" realizoi debatin e hapur të rradhës. I ftuar ishte Prof. Dr. Agim Mamuti, profesor i lëndëve ekonomike dhe dekan i Fakultetit të Shkencave Teknike. Tema në fjalë ishte interesante jo vetëm për studentët e ekonomisë, por edhe për studentët e drejtimeve tjera të cilët në mënyrë aktive morën pjesë me pyetjet dhe opinionet e tyre. Në fund u konkludua se:

- Përhapja e krizës së COVID-19 do të shërbejë si një test për ekonominë e Ballkanit Perëndimor.
- Kjo është një goditje për sistemin shëndetësor në tërësi, që kërkon ngrirjen e përkohshme, të ndërgjegjshme dhe të nevojshme të aktivitetit me qëllim ngadalësimin e përhapjes së virusit.
- Politikat ekonomike në vetvete nuk janë të mjaftueshme për t'i dhënë fund krizës.
- Një rikuperim i shpejtë ekonomik është i mundshëm, por jo i sigurt.
- Vendet duhet të shfrytëzojnë të gjitha opsionet e mundshme për menaxhimin e krizës. /



Konferenca III ndërkombëtare për interkulturalizmin me temë boshte „arsimi interkulturore”.

Nën masa të posaçme për mbrojtje nga virusi COVID-19, në Universitetin “ Nënë Tereza ” - Shkup, u zhvillua Konferenca e tretë shkencore ndërkombëtare për interkulturalizmin, me temë „ Arsimi interkulturore”.

Mirëseardhje në konferencë pjesëmarrësve u uruan rektori i UNT-së, prof.dr. Aziz Pollozhani, dhe kryetari i Senatit prof.dr. Blerim Saiti. Njëkohësisht, Rektori Pollozhani ishte edhe një nga ligjëruesit e konferencës dhe zhvilloi tezën „Sistemi arsimor, faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie interkulturore”.

Koordinatori i konferencës prof.dr. Mustafa Ibrahimimi zhvilloi tezën “ Reformat gjuhësore në arsimin e shoqërive shumëkulturore - rasti Maqedonia e Veriut ”. Sipas profesor Ibrahimimit qëllimi i studimit mbi Interkulturalizmin dhe adresimi i marrëdhënieve ndëretnike në arsim nëpërmjet reformave gjuhësore, kontribon në ndërtimin e bazës për mirëkuptim të përbashkët dhe të ndërtimit të shoqërisë kohezive. Nxënësit janë të ngarkuar me stereotipe dhe paragjykime etnike (kryesisht pozitive për grupin e vet etnik, kurse negative për “ të tjerët ”), për të cilët ekziston mundësi e madhe të jenë të përkrahura prej arsimtarëve të cilët në mënyrë identike i perceptojnë bashkësitë etnike.



Prof.dr. Rizvan Sulejmani, i cili ligjëroi në temën “ Arsimi interkulturore dhe kultura në kohë Pandemie ”, tha se situata i largoi nga bankat shkollore shumë nxënës e studentë për çka ata, nxënësit, shtetet e tyre, por edhe bota do të paguaj çmim për disa dekada. Për të nxjerrë në pah disa nga pasojat e ndërprerjes së mësimin për ne si shtet multietnik dhe multikulturore me metodë komparative duke përdorë të dhëna nga studimet e bëra në disa shtete si Amerikë e Britani do të mundohemi të zbardhim pasojat e mundshme për shtetin tonë në pikëpamje etnike nga mbyllja e shkollave dhe universiteteve. Në fund të mundohemi të japim disa konstatime dhe sugjerime si të zbuten pasojat nga kjo pandemi.

I ftuar special i konferencës ishte Don Lush Gjergji, i cili foli për “ Nënë Terezë - si simboli i paqes dhe dashurisë, mishërimi dhe paradigma e interkulturalizmit universal ”. Ai tha se Nënë Terezë Bojaxhiu e kishte takuar shumë herë gjatë njohjes, shoqërimit dhe bashkëpunimit me të, në meridianët të ndryshme të botës, që nga takimi i parë personal në Romë më 29 mars 1969, ndërsa e kishte shoqëruar në pesë vizitat e saja në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, 1970, 1978, 1980, 1982, 1986.

Prof. dr. Rubin Zemon foli në temën “ Historia, antropologjia dhe kompetencat ndërkulturore ”, ndërsa prof. Ajtene Hajdari - Qamili, për “ Interkulturalizmin në institucionet publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut ”.

prof. Berton Sulejmani, foli në temën „ Interkulturalizmi gjuhësorë nëpërmjet frazeologjizmave në gjuhën shqipe dhe maqedonase ”, prof. Ismet Osmani, për „ Interkulturalizmin në procesin edukativ-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut ”, prof. Sunaj Raimi, në temë „ Disa komponentë interkulturore në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm ” dhe prof. Mixhait Pollozhani, në temën „ Arti si veprimtari e kultivimit të interkulturalizmit ”.

Konferencën Ndërkombëtare „MIGRIMI, LËVIZSHMËRIA DHE COVID-19: Implikimet e tanishme dhe të ardhshme” („ MIGRATION, MOBILITY AND COVID-19: CURRENT AND FUTURE IMPLICATIONS ”).

Jemi dëshmitarë se kriza e shkaktuar nga virusi COVID-19 ka lënë në hije debatet ekzistuese të mi-



gracionit, por gjithsesi ajo është e lidhur në mënyrë të pandashme me lëvizjen. Pandemia COVID-19 ka ndikim të pashembullt në lëvizjen njerëzore në përgjithësi. Masa të ndryshme u zbatuan për t'iu përgjigjur virusit dhe për të zvogëluar përhapjen e virusit duke përfshirë bllokimin, kufizimet e udhëtimit dhe mbylljen e kufijve. Një numër i madh i migrantëve ishin të bllokuar ose të kthyer me forcë në vendin e tyre të origjinës. Ndërsa shumë sektorë të tillë si bujqësia u përballën me mungesën e punëtorëve. Shumë familje nuk mund të ribashkoheshin për shkak të kufizimeve të udhëtimit. Masat e bllokimit provokuan mbylljen e bizneseve dhe papunësinë. Kështu, remitancat nga komunitetet e mëdha të diasporës jashtë rajonit ranë. Si përmbledhje, pandemia solli në fokus rolin jetësor që luajnë migrantët në shoqëritë tona dhe ngriti pyetje për një qeverisje më efektive të migracionit. /

Konferencën e katërt ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm „tsd 2020”.

Në konferencën e cila u zhvillua në dy pjesë, me prezencë fizike, hapja e konferencës ku morrën pjesë një numër shumë i kufizuar i folësve, ndërsa e njehta do të zhvillohej në përputhje me të gjitha rekomandimet për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19, dhe pjesa e dytë online ku u kyçen mbi 60 folës. Konferencën e hapi rektori i UNT-së prof. dr. Azis Pollozhani, ndërsa folës në të kanë qenë Ministri i Financave Prof. dr. Fatmir Besimi, zëvendës minis-

tri i Arsimit dhe Shkencës Prof. dr. Arafat Shabani, dhe ministri për Administratë Publike dhe Shoqëri Informatike dr. Jeton Shaqiri. Konferencën do ta moderon kryetari i konferencës, Prorektori për Shkencë në UNT, Prof.dr. Bekim Fetaji. /



AGENDA - (18.12.2020)

09:00 – 10:00	REGISTRATION
09:00 – 13:30	Conference Ceremonial Part with Physical Attendance LOCATION: (303) Third Floor UMF
9 min	Moderator – Conference General Chair (Prof. Dr. Bekim Fetaji)
9 min	UNT Rector – Opening Speech for the Conference (Prof. Dr. Azis Pollozhani)
3 min	Minister of Finances (Dr. Fatmir Besimi)
3 min	Vice Minister of Education and Science (Dr. Arafat Shabani)
10 min	OSCE Mission North Macedonia / Ambassador Cleopatra Kopa
10 min	Minister of Information and Administration (Dr. Jeton Shaqiri)
9 min	UNT Rector – Closing Certificate for Speakers (Prof. Dr. Azis Pollozhani)
11:15 – 12:00	BRIBAN
12:00 – 16:30	Online Academic Part of the Conference – ONLINE using Video Links - Google Meet (NOTE: please, firstly log in into your email and then click on the link to connect to your session.)
12:00 – 16:30	Session 1 – The role of Technical Developments for Economic Sustainability Online Video Conference Link 1: https://meet.google.com/xtm-300-004
12:00 – 16:00	Session 2 – Sustainable Planning in Context of Urbanization, Spatial Planning and Architecture Online Video Conference Link 2: https://meet.google.com/tpj-424-264
13:00 – 16:30	Session 3 – Sustainable development through Innovation and R & D Online Video Conference Link 3: https://meet.google.com/tdk-111-111
12:00 – 16:30	Session 4 – Impact of Contemporary Technologies on Sustainable Development Online Video Conference Link 4: https://meet.google.com/tdk-111-111
12:00 – 16:30	Session 5 – Sustainability in Social Context, Education and Miscellaneous Online Video Conference Link 5: https://meet.google.com/tdk-111-111
16:00 – 16:30	Round Table and Question and Answer - separately for each session

Shpikësi i tre aplikacioneve për përdoruesit e platformës “LinkedIn”

Alejna Saiti

Endrit Rushiti student i “ Universitetit Nënë Tereza “ - Shkup, Fakulteti i Shkencave të Informatikës, programi studimorë Informatikë, sjell aplikacionin e tretë me radhë i cili u dedikohet të gjithë përdoruesve të platformës “ LinkedIn”

Endriti ishte vërtet 20 vjeç kur krijoi aplikacionin e tij të parë për telefonë, “ Movie Diary “ projekt i cili pati mjaft sukses, më pas vazhdoi me aplikacionin e tij të dytë “ Applinka “ e cila arriti një sukses të madh por që qëllimin akoma nuk e ka arritur shkaku i pandemisë, nuk ngelet me kaq tash më është aplikacioni i tretë me radhë i quajtur “ Video Downloader for LinkedIn “.

Aplikacioni “Video Downloader for LinkedIn” është një aplikacion i thjeshtë që kryen një punë të caktuar, me pak fjalë shkarkon video nga rrjeti social “LinkedIn” në telefonin tuaj. Duke parë se ky funksion nuk ishte i ofrueshëm nga vetë platforma “LinkedIn” dhe që nuk kishte ndonjë opsion të tillë që të lejon shkarkimin e videove Endriti na krijoi një aplikacion specifik për atë funksion. Qëllimi i këtij aplikacioni është që të zgjidh një problem në mënyrën më të lehtë dhe më praktike të mundshme dhe poashtu të

ofroj zgjidhje për një problem që nuk kishte zgjidhje. Aplikacioni është e vetmja zgjidhje për problemin në fjalë “ Shkarkim të videove nga platforma LinkedIn “ , thekson Endriti.

Aplikacioni ka arritur rezultate shumë të mira , në më pas se 3 muaj , ka kaluar shifren e 10K shkarkimeve nga platforma “GooglePlayStore” tash më një shifër shumë më e lartë se ajo duke qenë e shkarkuar në më shumë shtete si: USA, India, Gjermania, Franca etj. Aplikacioni është shumë i thjeshtë për përdorim. Për të gjithë përdoruesit që dëshirojnë të shkarkojnë video nga rrjeti social “ LinkedIn “ mjafton që të shkoni tek video që ju dëshironi të shkarkoni në platformën “LinkedIn” , shtypni opsionin “More” dhe pastaj kopjoni linkun e videos. Pas asaj mjafton që të hapni aplikacionin “ Video Downloader For LinkedIn “ dhe të vendosni linkun e videos dhe shtypni butonin “ Download “.

Endriti na tregoi se ne krahasim me aplikacionet e tjera që ka krijuar më heret “Movies Diary” dhe “Applinka” ky aplikacion ishte shumë më i thjeshtë dhe një projekt shumë më i vogël, kishte një problem specifik dhe ofron një zgjidhje specifike vetëm për atë problem. Kjo tregon se ndonjëherë nuk nevojitet ndonjë zgjidhje e veçantë, ndonjë inovacion apo ndonjë zgjidhje madhështore por mjafton që të gjeni një problem që kan njerëzit dhe të ofroni zgjidhje për atë problem dhe ju do keni sukses. /



Studentët e përzgjedhur të UNT-së për “ese më të mira”

Studentët e UNT-së gjithmonë të angazhuar mbas aktiviteteve të ndryshme, në të cilën nuk hezitan që të marrin pjesë dhe në konkursin për “Esenë më të mirë” në shpërblym për të vizituar kryeqendrën e Evropës më konkretisht Brukselin. Gjatë këtij konkursi u zgjodhën dy studentë nga Universiteti “Nënë Tereza” - Shkup dhe dhjetë nga universitetet e ndryshme.

Drin Alija i diplomuar në Universitetin “Nënë Tereza” - Shkup Fakulteti i Shkencave Sociale drejtimi Studime Evropiane.

Pas një konkursi për esenë më të mirë unë së bashku me njëmbëdhjetë studentë të tjerë prej të gjithë Universiteteve të RMV-së kemi pasur mundësinë që të vizitojmë kryeqendrën e Evropës e më saktë Brukselin, aty kemi pasur mundësinë të vizitojmë institucionet e Bashkimit Evropian si Parlamentin Evropian, Këshillin e Bashkimit Evropian, Shtëpinë e Historisë Evropiane etj. Për mua si student në drejtimin e Studimeve Evropiane ishte një përvojë e paharrueshme të vizitoja këto institucione dhe t'i shohë se si funksionojnë pasi që ka dallim mes asaj që kemi mësuar në teori dhe ti shohim se si funksionojnë në praktikë.



Abid Gafuri student i Universitetit “Nënë Tereza” - Shkup Fakulteti i Shkencave Sociale drejtimi Studime Evropiane.

Në vitin e dytë të studimeve të mia në Universitetin “Nënë Tereza” - Shkup, në cilësinë e studentit pranë



këtij universitetit konkurova në një nga konkurset e SÇE-së. Këtë konkurs e fitova për të marrë pjesë në një vizitë studentore në të gjitha institucionet e BE-së në Bruksel. Pasi që unë studioj në drejtimin Studime Evropiane kjo vizitë studentore ka qenë një nga eksperiencat më produktive që më mundësoi gërvshetimin e pjesës teorike me atë praktike. Të gjithë e dimë se Brukseli, përveç si qendër politike, paraqet qendër të historisë dhe kulturës evropiane. Mundësia që mu dha ti shohësh edhe nga afër këto ishte e jashtëzakonshme dhe gjithë kjo arritje e imja është fal ligjëritimit të profesorëve në këtë universitet, që me ligjëritimin e tyre më është mundësuar të përfitoj njohuri. Të cilat do t'i shfrytëzoj në të mirën time. /



Përvoja dhe sukcesi i tyre si motivim dhe frymëzim për studentët e rinj!

Alejna Saiti

Agon Podgragja student i universitetit Nënë Tereza - Shkup, me programin studimor informatikë-mësimdhënie. Tani jam në përgaditje të temës së diplomës. Si ish kryetar i parlamentit studentor ajo që unë dua të shpreh nuk njeh kufi, sepse kjo kohë ishte krijimi personalitetit tim dhe njohja e vetvetes gjatë këtij rrugëtimi por ajo që unë sot dua ta potencoj si fillim është falemnderimi ndaj dekanit, profesorëve dhe stafit administrativ për punën e palodhshme që e bejnë dhe që janë çdoherë në hap me studentat sepse çdo fillim është i vështirë por këtë nuk e ndjemë fare falë mbështetjes së tyre. Rruga dijes është e vlefshme dhe na shoqëron tërë jetën, dua të jap mesazh atyre që kanë filluar ose dëshirojnë të fillojnë këtë rrugë në universitetin tonë se nuk do të zhgënjehen nga zgjidhja tyre. Thashë “universitetin tonë” pasi që kjo është bërë shtëpia jonë e dytë, ndihemi rehat dhe të mirpritur gjithmonë. Ishte një kohë e bukur ku kur kupton se i erdhi fundi të bën të ndjehesh keq, sepse njeriu gjithmonë ka nevojë për një fjalë të bukur, për një mësim me shumë, një


pershendetje të ngrohtë etj dhe e kupton se duhesh të ndahesh nga një familje e gjërë që ke bërë. Shpresoj që çdo student të ketë fatin të kalojë në hapat që kaluam ne si gjeneratë, sepse është një udhëtim i bukur që nuk do të mbarojë kurrë.



Jetë dhe rrugëtim i etur për studime, fillojnë shkëndijat e para mbi veprimtarinë time studimore. Unë, **Besir Ibishi** i lindur në Shkup, rritur dhe zhvilluar kryesisht në një komunë me zemërgjerësi të lartë ajo e Çairit, mes miqësh bujar dhe të suksesshëm. Shkollën fillore të kryer në Shkup dikur e quajtur “Dame Gruev” ndërsa sot “7 Marsi”, ku më pas studimet e shkollës së mesme i zhvillove në QSHA “Boro Petrushevski” po ashtu në qytetin e Shkupit drejtim teknik. Duke marrë në konsideratë situatat e krijuara jo të këndshme për vendin dhe shoqërinë tonë i dhashë vetes sime 360 shkallë kthesë dhe në vitin 2011 regjistrova studimet e ciklit të parë pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës në drejtimin Shkenca Politike, ky



drejtim që më dha një dashuri mbi sferën shkencës dhe dijes, gjithmonë duke qenë falënderues mbi Pedagogët shembullorë që dhanë shumë mbi mua dhe gjithë ne. Realisht i gjithë ky cikël zgjati vetëm katër vite, respektivisht në vitin 2015 i diplomuar Politikolog. I rritur mesatarisht në një familje me standard jo të nivelit luksoz potencoj që në bazë të suksesit isha përfitues i çdo vitit studimor në bursa studentore (sektor privat). Pas dy vite pauzë studimore në fund të vitit 2017 aftësitë intelektuale u bë që ti vë në funksion pranë tempullit më të ri në Shkupin dardan, ajo e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup. Fillova në stafin administrativ me shumëllojshmëri të punëve, duke marrë në konsideratë numër të vogël të të punësuarve si një Universitet i ri, por me sfida të shumta. Tani, ky tempull çdo ditë e më shumë po shtohet në cilësi, me staf të mrekullueshëm të administratës po dhe me një shembëlltyrë Profesorësh. Edhe se vazhdoja të punoja brenga për të vazhduar me studimet posdiplomike nuk ishte shuar asesi, madje ditë e më shumë shtohet. Pas një përkushtimi të procedurave mes UNT dhe MASH-it, Universiteti vitin 2019 hapë konkursin e ciklit të dytë, Master. Me shumë aplikova dhe që sukcesi i studimeve paraprake më dha një dritë jeshile që isha i pranuar. Studimet e ciklit të dytë regjistrova pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në drejtimin Punë sociale dhe Politikë Sociale, drejtim që në bazë të hulumtive para regjistrimit hasa shumë pak e zhvilluar në mesin e shoqërisë sonë, duke mos anashkaluar dhe problematikat sistematike që herë dhe shumë shpesh haset vendi dhe shoqëria jonë. Për atë arsye doja të bëhesha një zë i shpresës ashtu siç bëjnë të gjithë arsimdashësit. Pa lënë me një anë dhe stafin e mrekullueshëm e Pedagogëve të UNT-së ku që në të gjitha hulumtimet e synuara që kishim si grup kolegësh na dilnin në sugjerime pozitive, ku po në të njëjtën formë intensivë dhe sot veprojnë. Edhe përsëri obligimeve të larta që kisha mbi punën pranë UNT-së për mua ishte sado pak e rëndë, pasi që çdo herë pas orarit të punës duheshte të sakrifikoja dhe planifikoja kohën mbi synimin e studimeve, fundja dashuria mbi sakrificën e studimeve është e pandalshme dhe që lodhja nuk ndihej edhe përsëri pagjumësisë në fund të tunelit egzistonte një dritë e cila quhej gjithëmonë shpresë, dhe që, më 28 dhjetor 2020 me sukses të lartë mbrojta temën e Magjistraturës pranë UNT-së. I tërë ky rrugëtim mbi studimet e mia u krijua në dashurinë e të parëve tanë që kishin mbi “Ilmin” (dijen) dhe gjithë atyre që sot na rrethojnë çdo ditë, familja dhe shoqëria e sinqertë! Rrugëtimi vazhdon...



Drin Alija i diplomuar në Universitetin “ Nënë Tereza “ - Shkup Fakulteti i Shkencave Sociale drejtimi Studime Europiane, për dallim nga kolegët e mi pasardhës eksperiencia ime dhe e ish kolegeve të mi në Universitetin “ Nënë Tereza “ do të jetë më ndryshe sepse ne ishim gjenerata e parë e UNT-së. Gjatë kohës sime si student në UNT kam pasur mundësinë të njoftohem me një staf të mrekullueshëm i cili çdo ditë e me shumë shtohet, të jesh student i ligjëruesve të Fakultetit të Shkencave Sociale për mua ka qenë dhe do të mbetet një kënaqësi e papërshkrueshme. Ka shumë raste të cilat do të kisha dashur ti cekë mirëpo do të përmend disa si për shembull vizitën se bashku me kolegët e mi në kampin e emigrantëve në Tabanoc ku kishim mundësinë të shohim se si menaxhohet një kamp, dua të cek edhe pjesëmarrjen time në organizimin e dy Konferencave të cilat ishin të organizuara nga stafi i UNT-së së bashku me ndihmën e studentëve (International Conference Towards Sustainable Development). Gjatë vitit të fundit të studimeve kemi organizuar një simulim të Këshillit Evropian me ndihmën e profesoreshës së nderuar Drenusha Kamberi ku ishte prezent Zv. Kryeministri Bujar Osmani , Rektori i UNT Aziz Pollozhani , Dekan të fakulteteve , Profesorë dhe Gazetarë, pas simulimit unë së bashku me një kolegë tjetër kemi përfaqësuar UNT në kryeqytetin evropian në Bruksel në një vizitë të 12 studentëve të RMV, ku patëm mundësinë të shohim për nga afër institucionet e BE-së për të cilat edhe studionim. Këto ishin disa nga përjetimet e mia gjatë periudhës tre vjecare në UNT, Universiteti i cili të jep mundësinë për aktivitete e përjetime të ndryshme. Unë në semestrin e ardhshëm kam vendosur të vazhdoj studimet e mia master në UNT pasi që gjatë tre viteve kam kaluar një kohë shumë të mirë dhe shpresoj që edhe studimet master do t'i përfundoj me sukses./

Përvojë e shkëlqyeshme shkencore, por edhe njohje me kultura, vende dhe njerëz të ndryshëm!

Esra Demiri

Dr. Diturije Ismaili, Koordinatore Akadematike për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Erasmus + është programi i Bashkimit Evropian që synon të mbështet arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin në Evropë. Momentalisht, ka një buxhet të parashikuar prej 26.2 miliardë €. Ky është pothuajse dyfishi i financimit në krahasim me programin e tij paraardhës (2014-2020). Programi i sapofilluar 2021-2027 vë një fokus të fortë në përfshirjen sociale, tranzicionin e gjelbër dhe dixhital, dhe promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike, etj. Ai mbështet përparësitë dhe aktivitetet e përcaktuara në Zonën Evropiane të Arsimit, Planin e Veprimit të Edukimit Dixhital dhe Agjendën Evropiane të Aftësive. Programi gjithashtu,

- mbështet Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale
- zbaton Strategjinë e Rinisë së BE-së 2019-2027
- zhvillon dimensionin evropian në sport


Erasmus + ofron mundësi lëvizjeje dhe bashkëpunimi në: arsimi i lartë, arsimi dhe aftësimi profesional, edukimi shkollor (përfshirë arsimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme), arsimimi për të rritur, rinia dhe sporti.



Universiteti “Nënë Tereza” që nga themelimi i tij është angazhuar në programin Erasmus+ duke aplikuar në komponenta të ndryshme që ky program po i mbulon. Vet rezultatet dhe sukcesi në trevjeçarin e fundit tregojnë se Universiteti ynë po ec shumë mirë pasi që çdo vit po rritet numri bursave të mobilitetit për studentët dhe personelin e Universitetit. Përveç projekteve të mobilitetit, stafi ynë ka aplikuar në Agjencion Kombëtar të Erasmus+ që operon në vendin tonë, si edhe në projekte për Arsimin e Lartë që mbulohen me komponentë të ndryshe.

Situata pandemike e vitit të fundit ka bërë që mobilitetet e studentëve dhe të stafit të pushojnë pasi që te të gjithë universitetet evropiane mësimi mbahet online dhe kjo ka ndikuar edhe në lëvizshmërinë e studentëve dhe personelit. Ne shpresojmë se nga fillimi i vitit të ri akademik 2021/2022 kufijtë të hapen dhe mobiliteti të zhvillohet normal. Andaj, inkurajoj të gjithë studentët që të aplikojnë dhe të shijojnë një eksperiencë ndryshe nga universiteti i tyre amë.

Endrina Fejzuli studente e Universitetit “ Nënë Tereza “ - Shkup, në Fakultetin e Ndërtimtarisë, Inxhinierisë së Komunikacionit dhe Arkitekturës. Një eksperiencë që jo vetëm më ka zgjeruar horizontin e njohurive, por më ka lejuar të marr përgjegjësi më të mëdha për veten time dhe të ndërtoj marrëdhënie besimi midis kombeve me punën dhe përkushtimin tim. Përmes Erasmus + mësova mënyrën e punës, mbi të gjitha pikëpamjet e studentëve moshatarë në Universitetin e Mariborit, Slloveni. Edhe pse një periudhë gjatë studimeve në Fakultetin e Ndërtimtarisë, Inxhinierisë së Komunikacionit dhe Arkitekturës u desh që ta kaloj në mënyrë virtuale, me çka nuk kisha mundësi për tu takuar fizikisht me



studentët e tjerë sloven, finlandez, italian, unë arrita ta përkthej respektin e tyre ndaj një kombësie, kulture tjetër.


Kjo ndjenë respekti ishte e dukshme në pozicionin tim në çdo grup, ku unë nuk isha thjesht një studente Erasmus +, unë isha pjesë e grupit dhe mendimi im ishte i rëndësishëm. Kjo arriti të më ekspozojë ndaj një kulture tjetër, me ide të reja, duke e përfaqësuar personalitetin tim me zë më të fortë. Një përvojë që nuk ishte vetëm frymëzuese për drejtimin që unë studioj, por gjithashtu pati një ndikim në perceptimin tim për qytetarët evropian në përgjithësi. Të gjitha këto kultura, vende dhe njerëz të ndryshëm të cilët unë i njoha, kontribuuan në një ndjenjë të shtuar për arkitekturën.

Floriana Murtezi e lindur në fshatin Opajë të komunës së Likovës, studente e Universitetin “ Nënë Tereza ” - Shkup, në Fakultetin e Shkencave Sociale , drejtimin “ Punë dhe Politik Sociale”. Në fillim nuk kisha shumë njohuri rreth asaj se çfarë ofron Programi Erasmus+, por falë stafit të UNT-së, u njoftova më detajisht lidhur me këtë program dhe vendosa që të konkuroj për të vazhduar studimet për një semestër në Universitetin e Turqisë. Mund të them se studimet në Turqi shkuan si është më së miri, pavarësisht vështirësive! Atje përveç që përfituam shumë gjatë ligjëratave, në aspektin profesional, gjithashtu gjatë qëndrimit në Turqi, në Universitet kishim rastin të njohim kolegë studentë nga vende të ndryshme të botës me të cilët shkëmbyem përvoja nga vendet tona përkatëse. Po të na ofrohet mundësia përsëri unë dhe shumë kolegë tjerë do të ishim përsëri pjesë e Programit Erasmus+.



UNT ka ndikuar shumë në përgatitjen time profesionale, por edhe përmes ofrimit të mundësive të ndryshme si psh: me Programin Erasmus+ , ka përfunduar edhe më shumë rrugëtimin tonë drejt përfundimit të suksesshëm të studimeve. Porosia ime për të gjithë shoqërinë, e veçanërisht për maturantët që mbarojnë arsimin e mesëm këtë vit është që, të vendosin vetë, pa ndikim, duke u konsultuar me student, lidhur me drejtimin për të studiuar. Të zgjedhin drejtime me perspektivë dhe drejtime ku e shohin veten më të përgatitur. E sigurisht se UNT ofron perspektivë për të gjithë ata.

Suhejla Ademi e lindur në Shkup më saktësisht nga Gazibaba, studente në Universitetin “ Nënë Tereza ” - Shkup, drejtimi Tekstil, Dizajn dhe Modelim. Arsyja përse ky drejtim



është sepse është ëndrra ime prej fëmijërisë dhe si çdo njeri ne mundohemi dhe luftojmë për gjërat që i dëshirojmë. Çdo gjë që ndodhi gjatë konkurimit dhe si u bëmë pjesë e programit Erasmus+ ishte papritmas, një ndër prej gëzimeve të mia ishte që u bëra pjesë e Erasmus+ dhe që na ofroi shumë gjëra të mira si dhe mësim për jetën tonë. Për mua ishte një ndër aventurat dhe eksperiencë me e mirë në jetën time. Një eksperiencë e pa harruar, e cila ndikoi shumë tek unë sepse më dha vullnet dhe vetqëndrim që mund të arrij vet pa ndihmën e askujt dhe se gjërat janë ndryshe nga rrethanat tona që gjendemi tani, si kultura dhe traditat e tyre, shoqërinë që kemi krijuar atje te pa harruar.

Gjatë studimeve në Turqi në zemrën e Ankaras në Universitetin “ Baskent ” ishte një nder dhe kënaqësi shumë e madhe për mua, si dhe nga ana e profesorëve që shumë mirë na kanë mirëpritur dhe na kanë ndihmuar për çdo gjë që kishim nevojë për nga ana e studimeve dhe jetës tonë atje studentore. Do të dëshiroja shumë të jem përsëri e Erasmus+ dhe pse jo në ndonjë vend tjetër për të bërë shoqëri dhe të mësojmë kultura, tradita, gjuhë tjera. Falemnderit të gjithë bashkëpunuesve, profesorëve dhe profesorehave të universitetit “Nënë Tereza ” - SHkup që na ndihmuan dhe kanë kontribuar pa masë për ne gjatë studimeve tona me Erasmus+. Çdo student duhet ta përjeton këtë eksperiencë./

Me rastin e promovimit të numrit të parë të Revistës dhe hapjes së Radios në UNT

Emel Aliju

Studentët me Radio “Studenti”

“Universiteti Nënë Tereza “ në Shkup me një ceremoni solemne modeste përuroi Qendrën mediale multifunktionale, në të cilën do të funksionojë “Radio Studenti “ dhe revista studentore “UNT student”.

Të pranishëm në ceremoni ishin, rektori i UNT-së Prof.Dr. Aziz Pollozhani, para profesorëve përgjegjës Agron Kurtishi dhe Mustafa Ibrahim, si dhe kryeredaktores së revistës Emel Aliju, dhe anëtarëve të redaksive përkatëse, shprehu kënaqësinë që edhe pse në kushte të jashtëzakonshme për punë, stafi i UNT-së ka gjetur mënyra të realizon një nga synimet e UNT-së, vënien në funksion të Qendrës mediale multifunktionale, që do të jetë zëri i studentëve.

“ Ky është një sinjal serioz nga ana jonë, i cili synon nga njëra anë përmirësimin e programit studimor të mediave, dhe nga ana tjetër përmirësimin e informimit për studentët dhe opinionit të gjërë rreth mbarëvajtjeve të aktiviteteve të UNT-së “, - tha rektori i UNT-së Prof.Dr. Aziz Pollozhani.



Përgjegjësi i Programit studimor të Mediave profesor Agron Kurtishi tha se hapja e radios është hapi i parë, dhe hapi i radhës, duke pasur parasysh se posedojmë të gjitha pajisjet e nevojshme, patjetër se është hapja e televizionit studentor.

Grupi redaktues : “Kordinatori i Revistës Prof. Dr. Mustafa Ibrahim, Kryeredaktorja Emel Aliju dhe anëtarët e redaksisë Sevdie Ramadani, Rasim Ajredini, Sejidina Azizi dhe Sumeja Limani.”

Promovohet numri i parë i revistës “UNTstudenti”

Prof. dr. Mustafa Ibrahim, si kordinator i revistës studentore „ UNT student “, theksoi se me daljen në dritë të numrit të parë të revistës studentore, për UNT është ditë e veçantë. Dalja në dritë e revistës shënon një hap i madh për gazetarinë në mesin e studentëve, të cilët me entuziazmin e tyre do të prekin tema dhe dukuri të ndryshme shoqërore, duke rezultuar edhe me zbulimin e talentëve të rinj, që padyshim UNT-ja shërben si një lulishte talentësh..

Kryeredaktorja e revistës studentore „ UNT student “, Emel Aliju falënderoi gjithë redaksinë e revistës së





parë për punën e palodhshme, si dhe koordinatorin Prof. dr. Mustafa Ibrahim për punën e palodhshme rreth koordinimit me studentët, si dhe rektorin Prof. dr. Aziz Pollozhani për inicimin e idesë dhe mbështetjes permanente. „UNT studenti është një ndër revistat e para të „ Universitetit Nënë Tereza „ Shkup e cila është punuar me shumë pasion dhe entuziazëm. Vetë titulli i revistës na tregon që është zëri ynë - zëri i studentëve. Tani e tutje zëri ynë do të dëgjohet më shumë se çdo herë „.

Kryetarja e Kuvendit Studentor të UNT-së, Hajrije Farizi tha se nga sot e tutje, zëri i studentëve do të dëgjohet më qartë dhe më zëshëm, tani më kur janë mundësitë e komunikimit shumë më të mira, siç janë dy mediat që u hapen sot në kuadër të UNT-së. /



Bisedë me Jakup Berishën – futbollist në KF “Shkupi

Kur sporti dhe studimi shkojnë bashkë

Jakup Berisha i lindur në Shkup, student i Universitetit “ Nënë Tereza “ - Shkup, futbollist, profesionist i angazhuar dhe shumë i përkushtuar gjatë gjithë kohës për këtë sport.

Futbolli për mua është punë që e bëj me pasion dhe mundohem gjithmonë ta bëj maksimumin që të arrij synimet e mëdha që i kam, të cilat arihen vetëm me punë të madhe dhe përkushtim maksimal në këtë sferë, dhe në çdo hap të jetës që e bëjmë për të arritur qëllimet tona. Ky sport kërkon gjatë gjithë kohës angazhim dhe për këtë arsye nuk është lehtë që të miresh me diçka tjetër, por unë mundohem që të arrij ti kryej dhe studimet sepse arsimimi dhe edukata janë çelsi i parë gjatë rrugës së suksesit, tha Berisha.

Si çdo profesionist që i ka vështirësitë e saja edhe ky profesionist i ka vështirësitë e veta. Berisha si një profesionist i përkushtuar në maksimum, si të gjithë futbollistët që në karrierën e tyre kanë hasur probleme të cilat nuk janë të lehta për ti kaluar, gjithashtu edhe ai është rastisur në raste të tilla. Por “ pikerisht në këto momente duhet të jemi më të fortë, ashtu siç kam vepruar unë, duhet ti kalojmë kto sfida që na vijnë në jetë, gjithmonë duke qenë optimist për të ardhmën dhe të përkushtuar me mund të madh për atë çfarë e kemi ëndërr “ thotë ai.

Synimi i çdo futbollisti është që të luaj në ekip dhe ligë sa më të madha, poashtu dhe Berisha synon që pas 5 viteve të jetë në ndonjë klub të madh në Evropë me perspektiva shumë të mëdha, në të cilën i urojmë suksese.

Berisha për shoqërinë dhe të rinjtë tanë la një porosi e cila na thotë që të “Mos dorëzoheni asnjëherë në jetë ! Jeta na jep sfida të ndryshme, të cilat ne nëse dorëzohemi deshtojmë dhe nuk mund ta arrijmë qëllimin që e kemi në fund. Të punojmë, të mundohemi, të sakrifikojmë që të ndjehen krenar familjarët tanë, rrethi më i afërt dhe populli jonë“ . /





Risitë e teknologjisë

Teknologjia më shumë se kurrë rreth nesh!

Shekulli XXI konsiderohet si shekulli i teknologjisë ku teknologjia çdo herë e më shumë po avancohet, ku secili njeri po bëhet ç'do herë e më i mvarur nga ky zhvillim. Edhe inteligjenca artificiale është njëra ndër llojet e zhvillimit të teknologjisë e cila po e bënë të mundshme që kompjuteri të ketë aftësi të veprjës si qënje njerëzore. Ky zhvillim i teknologjisë po paraqet një zhvillim të madh ku është mundësia që inteligjenca artificiale ta mposht njeriun. **Ajsun Ismaili**

Viti që lëmë pas, nuk ka qenë aspak i mirë sa i përket të dhënave për gjendjen e ambientin dhe statistikave të ngrohjes globale. Kjo ka bërë që çdo zbulim i ri të koncentrohet në sigurimin e një ambienti të qëndrueshëm duke mos shkaktuar ndotje. Në 2020-tën, kemi parë biçikleta, dronë e vetura elektrike, por 2021-ta, pritet të sjellë shumë më shumë pajisje e makineri të reja që funksionojnë duke përdorur energjinë elektrike nga burime të ripërtëritshme.

Pas gati një dekade zhvillimi, rrjetet 5G janë gjëja tjetër e madhe në internetin e telefonave celular që ofron një shpejtësi transmetimi të paparë. Këto rrjete me shpejtësi të lartë, nga ana tjetër bëjnë të mundur një mori të tërë trendesh të tjera të përparuar të teknologjisë, nga aplikacionet komplekse të makinërisë deri tek automatizimi i shtuar dhe realiteti virtual që mund të ndikojë në pothuajse çdo industri të madhe dhe të jetë një themel për ekonominë e ardhshme digjitale.

Pjesët teknologjike prej viti në vit e kanë ndryshuar jetën e njeriut duke e bërë më të lehtë punën dhe jetën, duke marrë parasysh vitet e shkuara që teknologjia nuk kishte qenë e zhvilluar edhe punët në të gjitha sferat kanë pasur vështësi të mëdha, duke e krahasuar në ditët e sotme zhvillimi teknologjik po na mundëson punën më të lehtë dhe një jetë më të sigurt. Me teknologjinë dixhitale që po mbin kudo duke përfshirë edhe trupat tanë kompjuterizimi sa vjen e bëhet më shumë personal. Tashmë teknologjia po bëhet mjeti ynë i informacionit, i kënaqësisë, i argëtimit, i sigurisë, i shëndetit, pra në një farë mënyre mbulon të gjitha sferat më të rëndësishme të jetës. Megjithatë, kjo e ardhme kaq e ndritur sigurisht e ka një kosto dhe në fakt, pak a shumë ruajtjes së jetës private po i vjen fundi. Sot jemi dëshmitarë të zhvillimit dhe ndryshimeve në fushën e shkencës, teknologjisë, kulturës dhe shoqërisë si dhe arritjes së informacioneve dhe komunikimeve të shpejta për rreth botës.

Gjatë vitit 2020, njerëzit në gjithë botën rritën përdorimin e teknologjisë duke besuar se ajo do t'i ndihmonte të përballonin pandeminë, por jo gjithmonë teknologjia ishte në lartësinë e duhur.

Njerëzit po përdorin teknologjinë si kurrë më parë, për punë, shkollë dhe vizita tek mjeku, për të qenë pranë familjes dhe shoqërisë, për mirë a për keq, ky vit ofroi mundësinë për të parë nëse teknologjia mund të luajë rol edhe më të madh në jetët e njerëzve. Në këtë kohë, shkalla e plotë e ndikimit të COVID-19 në jetën njerëzore, ekonominë globale dhe ndërmarrjet nuk dihet ende. Por tashmë, ajo është bërë një katalizator i jashtëzakonshëm për ndryshime. Nevoja për inovacion është më e madhe se kurrë, e nxitur nga sfida të reja që janë më përçarëse se sa më shumë janë përballur ndonjëherë.

COVID-19 i ka bërë trendet tona të Vizionit të Teknologjisë më të rëndësishme dhe urgjente se më parë. Mundësitë për të cilat bizneset priten të kenë vite për tu përgatitur po afrohen shpejt. Për të përmbushur këto sfida, organizatat do të duhet të përtërijnë, shpiknin dhe ripërcaktojnë vetveten. Njerëzit varen nga teknologjia më shumë se kurrë. Sa shpejt dhe me përgjegjësi e vendosin ndërmarrjet, ka më shumë rëndësi se kurrë, gjithashtu. Ne po jetojmë në një kohë të paparë, duke shkuar drejt një të ardhmeje që ndryshon shpejt. /



Bisedë me shkrimtaren e re Elvane Mustafa, me rastin e botimit të romani të saj të parë “A më beson”

“A më beson” romani përtej imagjinatës!

Emel Aliju

Elvana Mustafa shkrimtare 24 vjeçare, e lindur në Shkup, studente e vitit të parë në Fakultetin e Shkencave Sociale e programit studimor Media dhe Komunikim. Pas një periudhe të gjatë kohore dhe realizimeve të qëllimeve të saja Elvana vendosi që studimet e saja ti vazhdon në Universitetin “ Nënë Tereza “ - Shkup. Duke theksuar se tani ishte koha e duhur për të filluar studimeve, në të njëjtën kohë ajo botoi romanin e saj të parë “A më beson”.



Elvanën gjithmonë e kishte tërhequr arti dhe pjesa e kreativitetit, andaj shkrimi dhe parukeria kishin qenë pasion që nga fëmijëria e saj. Ajo ndoqi studimet për parukere që nga mosha 15 vjeçare, e cila në moshën 21 vjeçare pasionin e kthehu në profesion duke hapur dhe sallonin e saj të parë. Por gjithsesi shkrimin nuk e kishte lënë pas dore gjatë asaj periudhe ka qenë dhe në proces të përmbledhjes së poezive të ndryshme e cila i shkoi deri tek një roman.


Në Maj të vitit 2020 botoi romanin e parë të saj “A më beson”. Në këtë roman bëhet fjalë për një karakter të fortë të një vajze që ka jetuar vetëm me gjyshen, e cila ka luftuar për të mbajtur premtimin që u’ a kishte dhënë prindërve të saj që do të shkonte drejt rrugës së suksesit, po ashtu bëhet fjalë dhe për një dashuri që ajo e kishte ëndërruar në një ishull. Me këtë autorja ka dashur që vetë lexuesit me imagjinatë e tyre të gjykojnë rreth dashurisë se “A ekziston dashuria apo ne përjetojmë iluzion!?” Por jo të gjykohet vetëm rreth dashurisë, të gjykohet dhe rreth të vërtetës së kësaj jete.



Ky roman është bazuar në disa zhanre të ndryshme në atë psikologjike, aventurë, romancë poashtu është dhe si një lloj udhërrëfyese për lexuesit. Pjesa tjetër mbetet të zbulohet nga këndvështrimi juaj të dashur lexues. Për të arritur me sukses deri tek qëllimet e caktuara sigurisht që nuk është aspak e lehtë, sidomos kur je dhe shtetase e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku përkrahja e shtetit mund të themi se është zero. Ky është vetëm fillimi i këtij rrugëtimi, qëllimet janë më të mëdhaja. Por, me besim të plotë dhe punë nuk është asgjë e pa arritshme, theksoi Elvana. /

Në organizim të UNT-së, për herë të parë në vend u zhvillua dita e cost-it

Emel Aliju



Dita e Informacionit të COST-it (COST Info Day) këtë vit u zhvillua për herë të parë në Maqedoninë e Veriut, ndërsa nikoqir i saj është gjithashtu për herë të parë Universiteti “ Nënë Tereza “ - Shkup. Konferenca, me afro 100 pjesëmarrës nga vendi dhe Europa u zhvillua online, duke shënuar kështu një eksperiencë të jashtëzakonshme për UNT-në. Fjalim mirëseradhës kishte rektori i UNT-së, Prof. dr. Aziz Pollozhani, fjalim hyrës z.Christer Halen, administrator i lartë për operacionet shkencore në COST, ndërsa fjalim përshëndetës drejtori i COST, Dr. Ronald de Bruin.

Temë diskutimi i Ditës së COST-it (Bashkëpunimi Evropian në Arsim dhe Teknologji), këtë vit ishin: Cili është programi COST, Si të merrni pjesë, Si të aplikoni, dhe Dëshmi nga pjesëmarrësit e kaluar të veprimit COST. Për përvojat e COST në Universitetin “ Nënë Tereza “, prezantuan profesorët e UNT-së, Bekim Fetaji dhe Diturije Ismaili.

COST ofron mundësi të rrjetëzimit për studuesit dhe inovatorët në mënyrë që të forcojë kapacitetin e Evropës për të adresuar sfidat shkencore, teknologjike dhe shoqërore. Tre prioritetet strategjike të COST-it janë:

- Promovimi dhe përhapja e ekselencës
- Nxitja e kërkimit ndërdisiplinor për shkencën e përparimit
- Fuqizimi dhe mbajtja e studuesve dhe inovatorëve të rinj

Të gjashtë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimorë janë përfshirë aktivisht në programin COST, duke u bashkuar në vitet në vijim: Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, që nga viti 1991, Maqedonia e Veriut nga viti 2002, Mali i Zi nga viti 2015, anëtar i COST në vitin 2018 u bënë edhe Shqipëria dhe Kosova. /

Ballkani i stereotipizuar!

Enisa Amiti

Ngjarja historike që la shenjë më të madhe në kujtimet kolektive të popujvet të Ballkanit, ishte zgjerimi dhe më pas rënia e Perandorisë Osmane. Nga fundi i shekullit XVI, Perandoria Osmane ishte bërë forca kontrolluese në rajonin e Ballkanit, edhe pse ajo ishte përqëndruar në rajonin e Anadollit. Me ardhjen e Perandorisë Osmane nuk erdhi vetëm pushtimi, por edhe vlerat dhe kultura, feja, gjuha, mënyra e të veshurit, ushqimet, traditat. Osmanlinjtë me vete sollën edhe një qytetërim të ri të bazuar në kulturën islame.

Emri i Ballkanit nis me Perandorin Osmane si emër që nënkupton një vargmal pyjor, por edhe me një kuptim tjetër, si rajon i mjaltit dhe gjakut. Kuptimi i fundit sa i përket emrit Ballkan, qëndron në atë se, osmanlinjtë e shihnin si vend me plotë pasuri dhe si rajon strategjikë, por që pushtimi i tij osmanlinjve u kushtoi me shumë humbje të ushtarëve.

Vendet e Ballkanit të pushtuara për gati 500 vite nga ana e Perandorisë Osmane, popujt ballkanik ishin të lodhura nga robëria e gjatë dhe si pasojë filluan të mendojnë dhe punojnë për t'u çliruar. Po-


pujt ballkanik duke parë dobësimin e Perandorisë Osmane, filluan që të bëjnë kryengritje. Në shekullin XIX, popujt e parë që nisën formimin e shteteve të tyre ishin: grekët, bullgarët, sërbët dhe malazezët. Pra, kah fundi i shekullit XIX në hartën ballkanike u shfaqën Greqia, Sërbia, Bullgaria dhe Mali i Zi. Tashmë Perandoria Osmane ishte e copëtuar dhe mjaft e dobësuar, ku si e tillë ajo priti Luftërat Ballkanike dhe Luftën e Parë Botërore.

Lufta e Parë Botërore u nxit në vitin 1914, si shkas ishte atentati ndaj mbretit austro-hungarez Franc Ferdinantit, atentat i kryer nga ana e Gavrillo Principit, pjesëtar ky i një organizate revolucionare me emrin Nova Bosna (Bosnja e Re). Atentati u krye në Sarajevë të Bosnjës, vend ky i cili ishte shembull i dallimeve kulturore dhe fetare. Gjatë dy luftërave botërore, rajoni i Ballkanit dhe popujt e vegjël përjetuan mizoritë të mëdha.

Luftërat do të vazhdonin në vitin 1991, Ballkani ishte prekur nga konfliktet të armatosur në ish-Federatën e Jugosllavisë, duke rezultuar me spastrim etnik, dhunime, masakra dhe vrasje masive e cila përfundoj me ndërhyrjen e forcave të Aleancës Veriatlantike (NATO-s) fillimisht në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe më pas në Kosovë.

Duke qenë një gadishull i vendosur në pjesën juglindore të Europës, gjithmonë ka luajtur një rol të rëndësishëm gjeopolitik dhe gjeostrategjik. Nga ky pozicion rajoni u ndërtua si një mozaik diversitetesh multikulturor, multietnik dhe udhëkryq ku do të takoheshin tre fetë hebraike.

Ky rajon shpesh është përballur me epitete stereotipe dhe fraza me konotacion negativ, si dhe kritika





Ashtu sikur Mesdheu që mund të quhet djepi i historisë njerëzore, kjo vlen edhe për Ballkanin, që nuk duhet doemos të lidhet me diçka negative, edhe pse fjala na shtyn të mendojmë për një teritor të pasigurtë dhe konfliktuoz. Duke qenë se diskursi gjithmonë ndërtohet nga të fortët, stereotipet do të shfrytëzohen si një instrument i fuqishëm politik duke ulur të tjerë për të qenë dikush tjetër lart.

të shumta. Frazat më të zakonshme për Ballkanin janë parafytyruar me konfliktet historike, apo me frymën e dominimit të orientalizmit. Nuk mund të mohohet që luftërat që shpërthyen në periudhën e viteve 90-të, do ndikonin dhe vazhdojnë të ndikojnë në jetën e shumë njerëzve edhe sot. Në Ballkan më së miri mund të përshtateshin epitetet negative dhe shpesh herë të hiperbolizuara.

Njeriu është i prirur të memorizoj gjatë gjithë kohës, por ndonjëherë nuk jemi aq të aftë të kuptojmë gjithë botën, ndaj këto lloj perceptime të shpejta mund të jenë dhe të gabuara. Duke i lënë stereotipet herë pas here nëpër syrtare që janë të shtrembëruara, por ndonjëherë dhe me baza të vërteta nga këto fraza mund të lindin edhe konflikte.

Stereotipet njihen edhe si përshtypje të ngurta që krijohen nga mos informacioni i saktë, ose edhe nga takimet duke filluar nga aparenca fizike për një njeri, veshja grupi etnik dhe atë fetar. Janë të frikshme kur ato nga personaliteti përgjithësohen dhe nuk pranohen, edhe në raste kur ju jepen argumente edhe fakte reale.

Ballkani, gjithmonë ka përfaqësuar një gjendje të ndërmjetme midis etapave të zhvillimit, duke etiketuar si gjysëm i zhvilluar, gjysëm i qytetëruar, gjysëm kolonial dhe gjysëm oriental. Një tjetër mungesë e ligjërit për Ballkanin ka qenë edhe tradita akademike, ku ky rajon ka qenë i përshkruar shumë herë përmes udhëpërshkruesve, misionarëve dhe agjenturave të huaja.

Një pjesë e mirë e teksteve që kanë qarkulluar në Evropën Perëndimore, të cilat janë bërë për Ballkanin janë udhëpërshkrime. Udhëtarët perëndimor shkrimet i bënin duke iu referuar përftyrimeve, temave dhe metaforave që ishin krijuar prej pushtimeve kolonizuese. Ata e përshkruanin vendin si të egër, anarki, mungesë ligjesh dhe si banorë gjysëm barbarë. Kjo përshtypje mund të krijohej varësisht nga udhëtimi i tyre dhe vështirësitë që mund të kalonin.

Frazat stigmatizuese kanë ndikuar edhe tek vetë popujt e Ballkanit, duke u ngurtësuar dhe duke e thënë me zë të ulët se nga vijnë, si dhe duke u çuditur nga epitete që dëgjojnë për veten, në Ballkan është ndërtuar një hirarki. Sllovenët nuk e llogarisin veten si pjesë e Ballkanit, ku kjo bën që kufiri në veri të jetë konvencional dhe jo natyrorë. Kroacia duke e pa Serbinë si vend më lindor dhe kjo e fundit duke i parë shqiptarët dhe boshnjakët si më oriental.

Ballkani ka një kulturë të mirëfilltë dhe autoktone e cila nuk i ngjan as me atë europiane, e as asaj aziatike. Treva e Ballkanit lindi një numër të madh figurash si Aristoteli, Sokrati, Leka i Madh, Gjergj Kastrioti dhe një seri personalitetesh që do të bëjnë histori.

Të jeshë në qendër nuk do të thotë të jeshë i humbur, të jesh në pozitë ku gjithë rrugët kalojnë nga ti nuk do të thotë të jeshë i humbur. Këto stereotipe nuk duhen të jenë pengesë dhe stagnim për progres për gjithë vendet e Ballkanit, përkundrazi duhet të jenë stimul dhe qëllim drejt zhvillimit dhe avancimit.

Stereotipet nuk mund t'i zhdukim, por mund të ulim ndikimin e tyre duke përdorur racion dhe duke kuptuar se çdo vend varësisht nga shtrirja gjeografike, populli, besimi dhe orientimi politik ka përparësitë dhe mangësitë e veta. /



Mos u dorëzo!

Jeta të gjithëve ju sfidon
Së paku edhe vetëm një herë,
Por, ajo di edhe t'ju rrëzojë!

Dikush nga ju ndoshta e ka provuar,
Kur Ju patët përballë rrugën e dështimit,
Por jo, Ju ditët përsëri të ngriheni!

Sa nga jush u kujtuan te thonë “ Mos u dorëzo “?
Ne e dimë se jo të gjithë e zgjasin dorën,
Madje gëzohen kur shohin dështimin tonë!

Rini! Ngrihe kokën lartë dhe qëndro në këmbë
Ti sot je më e fuqishme se asnjëherë më parë,
Tregoju të gjithëve se t'i di të ja dalësh mbanë!

Sikur të rëzohesh edhe me qindra herë
Dhe si Feniksi do të ringjallesh përsëri,
Le ta di bota se ne jemi më të fortë se më parë!

Emel Aliju

Të jeshë femër

Më shkilni pra, më bëni urrë
E vërtetë, unë nuk jamë burrë
Më lini anash, mos më dëgjoni
Fjalët e mia, janë fjalë koti
Nuk jam për punë, as për komandë
E lëre më për ndonjë debatë!
Kudo të sillësh, të thonë je për në shtëpi
Nuk ke kapacitet, për punë tjera ti!
Rruaji fëmijët, mos fol më tepër
Po të lash unë, stë merr kush tjetër
Më thurri kurthe, mi zini udhët
Nuk ka forcë, do të përkulet
Pikë të dobët, gjithmonë morali
Është femër, nuk do të ja dali
Feston e tërrë bota, të lind djalë
Po të mos kenë femra, si do ja bëjnë vallë?
Kush e dha këtë urdhër, mos ndoshta zoti?
Jo more njerëz, te juajat janë fjalë koti!
Jam për shtëpi, por edhe për punë
Jam për debate, di të mbrohem unë
Kam disa kokrfa mendje, po sa ke ti
Jam edhe për politikë, a ke pa si udhëheq një femër ti?
Kam dashuri sa asnjë burrë
Kam ngrohtësi, se bëhem nënë
Të ruaj ty, ni pafsha dhe djemtë e mi!
Vlerëso gjithmonë një femër, si nënën ti

Elvan Mustafa

O shpirti im

O shpirti im i dehur
Të ka lodhur ky mision
Të ka shkundur të ka prerë
Mos e ndij veten si i pa vlerë
Azgjë nuk ka mbaruar
Mos u friko shpirti im
Nuk do jesh i haruar
O shpirti im i dehur e i lëkundur
Rri në një vend i ngulur
Drejtoju drejt vendosshmërisë
Beso dhe bëhu punëtor i përsosmërisë
Në të majtë në ke humnerë
Në të djathtë shiko një herë
Ndoshta drita do të vijë
Do të vijë me ty të rrijë
Të bëhet shokë, e të bëhët mik
Ai me ty do rrijë nuk do të ik
Të ka lodhur mendja jote
Dëgjo zemrën ç'farë do të thotë
Nuk ka faj dielli që është i ngrohtë
Ka faj njeriu që botën e ndot
Një emocion dashurie lësho përplotë
Lere le të bëhet epitë
Sa do që të bijë shiu i urrejtjes
Do e thajë dielli yt i përpjekjes
Liroje borën e bardhë te bie prej qielli
Liroje oksigjenin te vijë nga pylli
Mos e ndalo kohën ti vetë
Mos harro një ditë vdekja edhe ty të pret.

Elvan Mustafa

Nëna

Ëmbëlsira e jetës është ajo hyjneshë
që flladit zemrën duke buzëqeshë
dora saj e artë më mban gjallë në jetë
e më ka perkrahur
sa herë vetëm kam mbet.

Kur kundërmon era e nënës
sikur pranvera në maj
shpirti më qetësohet e ndjehem e gjallë
sepse gjithçka që kam ka qenë falë saj.

Një forcë përtej kësaj bote
që çdo ditë më rinon
është dashuria e nënës
që kurr nuk shterron.

Avidane Shabani

Shiu në mesnatë

Bie shi në mesnatë,
toka laget, më s'është e thatë.
Qielli fillon të murmuroj,
e zhurmë tokës t'i shkaktojë.

Dëgjoj rreshjet që shiu lëshon,
e zemrën time e qetëson,
mallin nga shpirti ma shkul,
përderisa unë rreth dritares jam ul.

Shikoj si qielli tani po qan,
kush e di sa derte po mban.
Ndoshta me lot largon merzinë,
e cila i mbeti mbi shpinë.

Njerëzve gjithashtu merzinë ua hjek,
që ua shkaktoi kjo jetë.
Dertet e mia dalë ngadalë,
i largon nga unë e i hedh në mal.

O qiell lësho lotët e tua,
se shpirtin më pastrojnë edhe mua,
i shtojnë bukuri natyrës,
dhe i japin dritë errësirës.

Anesa Rexhepi

Mallkoi veten

Ky shpirt një dashuri kishte,
atë e humbi.
Një sinqeritet e kishte,
atë e humbi.
Një shoqëri që kishte,
atë e humbi.
Të gjithë njerëzit që i donte,
ky shpirt i humbi.
Kush e mallkoi këtë shpirt,
që gjithçka po humb.
Çtë keqe paska bërë ky shpirt,
që e mallkuan.
Apo mos mallkoi veten,
për diçka që nuk arriti.
Dhe humbi gjithçka,
që ky shpirt kishte.

Jahja Abazi

Ftesë Rinisë

Me një laps mbi një letër
Ulem për të shkruar
Me disa fjalë të shkurta
Rininë tonë për ta përshkruar.

Ardhmëria e këtij vendi
Jemi ne oj rini
Mos lejoni që armiku
Në mes të na hyj.

Barka e shpëtimit
Për popullin tonë ne jemi
Besnikërinë e diturinë
Si armë më të forta i kemi

Për trima e trimëresha
Vendi jonë ka nevojë
E jo si këta të shumtit
Që vetëm flasin me gojë.

Le t'iu themi "Mjaftë"
Fjalëve dhe premtimeve t'kota
Është koha për punë dhe vepra
Që për të mirë të na njeh bota.

Po na kalon rinia
Duke i thënë vetes se do bëhet mirë
Duhet ta luftojmë të keqen
Që të jetojmë të qetë e të lirë.

Ta ngremë zërin lartë
Forcat t'i bashkojmë
Dhe pa pasur frikë
Të drejtat tona t'i kërkojmë.

"Nëse jeta të tregon se sa e vështirë është, atëherë edhe ti tregoi sa i/e fortë je"

Sejidina Azizi

Liria dhe Mjerimi

Më në fund lirinë mund ta shoh edhe unë.
Por mjerimi gjithmonë do të mbetet këtu,
Do mbetet nga disa njerëz,
Të pa cipë të pa nderë,
Që e vdhjedhin këtë popull të mjerë.
Këtë popull të vuajtur ndër vite,
Që lirinë e fitoi,
Por mjerimin kurr nuk mundë ta largoj.

Jahja Abazi

Trajnimet e Studetave të UNT-së

Alma Maliqi

Sudentë të UNT-së në forum bashkëbisedues me ministrin e Jashtëm Bujar Osmani

Studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale, pranë Universitetit 'Nënë Tereza' në Shkup, të prirë nga Prof. dr. Argëtim Saliu zhvilluan sot vizitë zyrtare në Ministrinë e Jashtëme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u pritën nga ministri Bujar Osmani, i cili në nder të tyre zhvilloi ligjeratë në temë diplomacia e vendit dhe sfidat euro-integruese.

Ministri i Jashtëm dr. Bujar Osmani tha para studentëve se nëse revista prestigjioze amerikane Time Magazine ka shpallur Vitin 2020 - Vitin më të keq që njihet njerëzimi, për shkak të viktimit që rezultuan nga paraqitja e pandemisë, dhe për shkak të pasojave që ka përjetuar ekonomia botërore, vendi ynë megjithatë kishte fat dhe kishte një arritje të madhe politike, dhe kjo është anëtarësimi në NATO, realizim i një ëndrre 30 vjeçare të vendit tonë.

Osmani tha se Maqedonia e Veriut nuk ka alternativë përpos anëtarësimin në BE, ndërsa tha se çdo e mirë që i ka ndodhur vendit gjatë 30 viteve të kaluara është rezultat i ndihmës permanente të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Studentët e UNT-së realizojnë me sukses seancën improvizuese e këshillit komunal pranë komunës Çair

Në kuadër të aktiviteteve të afrimit nga pjesa teorike në atë praktike grup studentësh të Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup, respektivisht pranë Fakultetit të Shkencave Sociale nën përkujdesin e Prof. dr. Rizvan Sulejmani realizuan me sukses, seancën improvizuese e këshillit komunal nga studentët e drejtimit - Administratë publike dhe burime njerëzore po dhe drejtimit të Studimeve Ballkanike dhe Euroaziatike si mësim praktik nga lënda e Vetëqeverisjes Loka. Studentët u mirëpritën nga kryetari i Komunës Çair z. Visar Ganiu po dhe nga kryetari i këshillit komunal, z. Zahir Bekteshi.

Të gjitha këto të trajtuar teorikisht më herët në lëndën e Vetëqeverisjes Lokale, e aprovuan edhe në mënyrë praktike.

Studentët e sportit pranë UNT-së në trajnim në natyrë

Studentët e Fakultetit të Shkencave Teknologjike, që kanë lëndë zgjedhore “Sportin dhe aktivitetet sportive” nga Fakulteti i Shkencave Teknologjike pranë Universitetit 'Nënë Tereza' në Shkup, për shkak të gjendjes pandemike, për të evituar mundësinë e infektimit nga virusi Covid 19, lëndën e mbajnë në natyrë, nëpër vende të posaçme për aktivitet sportiv. Nën udhëheqjen e profesoreshës Yllka Cemena ata mëngjeset i kalojnë me ushtrime fizike, për të përmbushur programin e paraparë, edhe pse në gjendje të jashtëzakonshme, ku preferohet mësimi online, që është i papërshtatshëm për këtë Program Studimo.

Këtë radhë ata kanë zgjedhur Parkun e Qytetit të Shkupit i cili ofron kushte optimale për mbarëvajtjen e mësimin në ambient të hapur, dhe njëkohësisht distancën fizike, të nevojshme për tu mbrojtur nga virusi Covid19.

Studentët e mekatronikës prezantuan pajisje të prodhuar nga vetë ata

Studentët e Mekatronikës të vitit të 3-të pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup prezantuan sot një pajisje për bluarje dhe përzierje, të dizajnuar dhe realizuar nga vetë ata. Studentët e vitit të 3-të, drejtimi Mekatronikë nën mentorimin e Prof. Dr. Shaban Buzës, në lëndën Teknologjia e Prodhimit në Mekatronikë 2, dizajnuan dhe realizuan një pajisje për bluarje. E veçantja e këtij projekti është se studentët ishin projektues dhe dizajnuer, dhe të njëjtin e realizuan si pajisje e cila u tregua si funksionale në kryerjen e detyrës së planifikuar. I pranishëm në prezantim ishte edhe Rektori Prof. Dr. Aziz Pollozhani. Studentët Ismail Sali, Ridvan Alii, Mensur Mejdi, Blerim Sulemani dhe Ubejt Lutfiu sot prezentuan dhe lëshuan në funksionim pajisjen multifunksionale, e cila si për detyrë të parë e ka bluarjen dhe pjesa e dytë përzierjen.

Pollozhani paralajmëroi promovimin e hapësirave të reja laboratorike, që do të funksionojnë në kuadër të Fakultetit Teknologjik.

Në fsht u zhvillua trajnimi: „shkathtësitë për sukses - youth empowered”

Në hapësirat e Fakultetit të shkencave teknike pranë UNT-së, drejtori i Qendrës për menaxhment konsalting, arsim dhe trajnime - MOTIVA, z. Zoran Kostovski zhvilloi trajnim njëditor me studentët dhe maturantët me temë: „Shkathtësitë për sukses - Youth Empowered”.Për realizimin me sukses të këtij trajnimi kontribuan përfaqësuesit e Parlamentit studentor, Suat Useini, Çlirim Tushi, Fatih Sadiku, si dhe ligjëruesi Mr. Valon Ramadani.

Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisën me Çertifikata nga trajnuesi dhe dekani i Fakultetit të shkencave teknike, Prof. Dr. Agim Mamuti.

Pedagogë dhe studentë të UNT-së morrën pjesë në debatin për të rinjë “edukimi mediatik”

Pedagogë dhe studentë të UNT-së morrën pjesë në debatin për të rinjë “Edukimi - alfabetizimi mediatik”, që u zhvillua në Shkollën e mesme ‘Zef Lush Marku’ në Shkup , si pjesë e projektit „Fuqizimi i qëndrueshmërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm të komuniteteve lokale në Maqedoni” mbështetur nga Ambasada Britanike dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, dhe i realizuar nga organizata ‘Centre for Common Ground’ . Studentët e UNT-së, të drejtuar nga profesoret Kaltrina Zekolli Shaqiri dhe Elizabeta Bajrami Ollogu, dhanë qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre se si duhet të rinjtë të mbrohen nga lajmet e rreme.

Profesoresha Elizabeta Bajrami Ollogu gjatë fjalës së saj u përqëndrua në tre arsye pse edukimi mediatik duhet të jetë pjesë e kurrikulave shkollore, duke arsyetuar se i pajisë të rinjtë me shkathtësi teknike, si të aksesojnë internetin dhe mediat online, pastaj shkathtësi kritike, të kuptojnë përmbajtjen e informacionit dhe ta interpretojnë cilësinë e tij, dhe shkathtësi praktike, se si ta përdorin informacionin e marrë.

Studentët e sportit zhvilluan trajnim në skijim

Studentët e programit studimor „ Sporti dhe Shkenca Sportive „, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit „ Nënë Tereza „ - Shkup, realizuan me sukses kursin 7 ditor të skijimit në Kodrën e Diellit. Studentët u trajnuan nën kujdesin dhe udhëheqjen e pedagogëve të këtij programi studimor, doc.dr. Agon Saiti dhe Mr.sc. Sedat Baftiu.

Ky kurs është pjesë e programit studimor „ Sporti dhe Shkenca Sportive „, që ka për qëllim aftësimin e studentëve me këtë kategori sporti dimëror. /



Të bashkuar mundemi më shumë!

Anëtarët e Kuvendit Studentorë



Përfaqësues të KS dhe studentë të programit studimorë Studime Evropiane pranë UNT-së pjesëmarrës në konferencën e 18-të rajonale në fushën e diplomacisë me temë “Politika, Diplomacia, Shqipëria dhe Ballkani” të organizuar nga Këshilli Rinorë Ballkanik-Tiranë

Anëtarë të Kuvendit Studentorë dhe studentë të UNT-së pjesëmarrës në debatin publik të organizuar nga Clcik Plus



Revista Studentore -UNT studenti



Studentë të UNT-së si dhe përfaqësues të KS morën pjesë në debatin publikë për të rinjë të organizuar nga Center for Common Ground me temë “Edukimi – alfabetizimi mediatik” si pjesë e projektit “Fuqizimi i qëndrueshmërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm të komuniteteve lokale në RMV i mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup



Me datë 05.03.2020 Kuvendi Studentor pranë UNT-së në takim me Parlamentin dhe Asociacionin Studentor të UEJL-së, me qëllim krijimin dhe fuqizimin e rrjetit studentor



KONGRESI KOMBËTAR STUDENTOR – TIRANË , Kryetarja e KS mori pjesë në Kongresin e parë Kombëtarë Studentor të organizuar nga Këshili Studentorë i Fakultetit të Shkencave të Natyrës – Universiteti i Tiranës



Përfaqësues të KS morën pjesë në takimin e realizuar nga “ National Agency and Mobility ”, ku pjesë e takimit ishin përfaqësues nga të gjitha universitetet publike dhe private me qëllim të forcimit të bashkëpunimit në të ardhmen, me theks të veçantë për fillimin e nismës për themelimin e rrjetit studentorë Erasmus ESN.



Kryetarja e KS së bashku me kryetarët e të gjitha universiteteve publike dhe private në vend prezantuan Deklaratën për të rinjtë, arsim dhe ardhmëri, para Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës znj.Mila Carovska



Grupi punues i studentëve të angazhuar vullnetarisht në Radio Studentin i cili do të udhëhiqet nga studentët, për studentët i mbikqyrur nga Kuvendi Studentor



Studentët e UNT-së së bashku edhe në ekskurzione



Emel Aliju dhe Alejna Saiti të angazhuara në radio studentin




Anëtarët e kuvendit Studentor vizituan shoqatën për fëmijë me nevoja të veçanta “ Dua Ylberin ”, ku në emër të gjithë studentëve të UNT-së ju dorëzuan dhurata 50 fëmijëve të kësaj shoqate .



Studentët e Fakultetit të shkencave Sociale pranë UNT-së , shënojnë online 2 prillin, ditën botërore të autizmit . Duke shpërndarë mesazhe sensibilizuese nëpër rrjetet sociale nën moten “ autizmi është aftësi dhe jo paaftësi”



vendi Studentorë gjatë periudhës së pandemisë ka organizuar edhe takime online me studentë dhe profesorë universitar të UNT-së për të diskutuar mbi temat më aktuale gjatë kësaj periudhe si dhe para 2 afateve të fundit të provimeve ka organizuar webianre online për menaxhimin e stresit gjatë periudhës së provimeve me psikologe të njohura dhe të dëshmuara profesionalisht në vend.



Me iniciativë te KS në bashkëpunim me Qendrën për menaxhment konsalting, arsim dhe trajnime – Motiva në FSHT u zhvillua trajnimi me temë “ Shkathtësitë për sukses- Youth empowered”



Si funksionon

UNT?

Universiteti “ Nënë Tereza ” - Shkup funksionon me pesë fakultete, të cilat ofrojnë 29 programe studimore deridiplomike, dhe 11 programe studimore pasdiplomike. UNT na ofron dy kampuse në dy objekte të ndryshme të Shkupit, siç janë kampusi A dhe kampusi B.

Në Kampusin A të UNT-së (Rektorati ndërtesa e sindikatës) janë të përfshirë:

1. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
2. Fakulteti i Shkencave Teknike
3. Fakulteti i Shkencave të Informatikës

Në kampusin B të UNT-së (Sh.F. Kongresi i Manastirit) janë të përfshirë:

1. Fakulteti i Shkencave Sociale
2. Fakulteti i Shkencave Teknologjike

Misioni është krijimi i një atmosfere që do të përmirësojë progresin e studentëve, sepse studentët janë ardhmëria jonë. Motivimi i tyre, shtytja e tyre dhe puna e tyre do të përmirësojnë ekonominë e vendit, dhe do të çojnë shoqërinë tonë përpara. Motoja UNT-së është “ Studentët janë në vend të parë “. Studimet bëhen në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze të cilat drejtohen nga rreth 100 profesorë dhe asistentë me përvojë, të cilët janë shtylla e vazhdimit të ndërtimit tonë si institucion i arsimit të lartë. Universiteti “ Nënë Tereza ” - Shkup filloi dhe me studime të ciklit të dytë, me çka jemi veçanërisht krenarë, sepse këto studime plotësojnë misionin tonë për të krijuar kuadër profesional që do të ndikojë në zhvillimin e shoqërisë.

Si mund ta kontaktojmë

UNT-në?



www.unt.edu.mk



[/untshkup](https://www.facebook.com/untshkup)



[/unt.sk](https://www.instagram.com/unt.sk)



[/unt.sk](https://www.snapchat.com/add/unt.sk)



+389 2 3161 004

